AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje"**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Fan S. Noli", Korçë**


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. dr. Çlirim Duro

2. Prof. asoc.dr Sonila Papathimiu


Mars/2025

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**
**Për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti "Fan S. Noli", Korçë.**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Fan S. Noli", Korçë |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Marketing-Turizmit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASR Nr. 260, datë 19.07.2021 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 Vite/ 6 Semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 29 PAE/ 0 PAK v.a. 2024-2023<br>28 PAE/ 4 PAK v.a. 2022-2023<br>28 PAE/ 4 PAK v.a. 2021-2022 |
| 18 | Numri i studentëve: | 25 Studentë v.a. 2023-2024<br>19 Studentë v.a. 2022-2023<br>9 Studentë v.a. 2021-2022 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Fan S.Noli" Korçë, është një institucion publik i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". UK është liçencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 230, datë 29.05.1992 dhe është riorganizuar me VKM Nr 213, datë 24.05.1994".

IAL UK është organizuar në 4 Fakultete:Fakulteti i Ekonomisë; Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë; Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane dhe Fakulteti i Bujqësisë. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë.

Fakulteti i Ekonomisë është i përbërë nga tre departamente:

1.Departamenti i Financë-Kontabilitetit

2.Departamenti i Marketing-Turizmit

3.Departamenti i Menaxhimit

Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga Departamenti i Marketing-Turizmit është realizuar sipas kritereve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UK dhe Rregullorja e programit të studimit.

Programi i studimit është ndërtuar mbi një përvojë të mirë institucionale dhe reflekton vlerat akademike dhe shkencore të saj. Ai ka në bazë zhvillimet social-ekonomike të vendit tonë dhe një analizë të tregut rajonal të punës. Rëndësia e këtij programi lidhet me fushën e Turizmit e cila po zhvillohet me ritme të shpejta brenda ekonomisë dhe biznesit dhe kërkon specialistë të pajisur me njohuri dhe aftësi të kësaj fushe.

Programi synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në turizëm si dhe me kopetencat dhe instrumentet themelore për rritjen e aftësive në përmbushje të kërkesave dhe pritjeve të tregut të punës.

Programi i studimit plotëson kriteret sa i takon organizimit dhe administrimit të tij, tipologjisë së lëndëve, si dhe ngarkesës së orëve dhe krediteve, e burimeve të nevojshme për realizimin me cilësi të studimit.

# PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bsc në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" ofruar nga Departamenti i Departamenti i Marketing-Turizmit, filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në IAL u realizua gjatë datave 29-30 Prill 2024 , ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ u takua me: Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Drejtuesin e Departamentit të Marketing-Turizmit, me Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, projekteve / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, grupin e vlerësimit të brendshëm(GVB), me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore si dhe stafin e sekretarisë mësimore.

Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc Muhamed Prezja.

## Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (UK), ofron programin e studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*", i ndyshuar.<br>Programi i studimit Bsc "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" ofrohet nga Departamenti i Marketing-Turizëm.<br>Programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" realizohet me 180 kredite dhe ofrohet në gjuhën shqipe. Ai zhvillohet në kohëzgjatje normale në 3 vite akademike, me 6 semestra. Synimet kryesore të programit të studimit janë, përgatitja e specialistëve të kualifikuar në fushën e turizmit.<br>Kjo është evidentuar në Statutin dhe rregulloren e UK, Regulloren e Fakultetit dhe Planin Strategjik të Zhvillimit të UK 2022-2027. Në këto evidenca theksohet se institucioni ofron programe studimi që kanë për qëllim të mbështesin prioritetet strategjike të vendit përmes formimit e kualifikimit të specialistëve të lartë të fushës së agrobiznesit në përputhje me vlerat akademike kombëtare.<br><br>*Ev.1.1 Statuti i UK*<br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UK* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, si dhe vizitën në Institucion konstaton se programi i studimit është hartuar në përputhje me mënyrën e organizimit të institucionit, të njësive kryesore dhe në përputhje me qëllimin dhe misionin e UK, të shprehur në Statutin e tij, ku synohet ruajtja dhe konsolidimi i vlerave akademike, përmes nxitjes së lirisë akademike, kërkimit shkencor, dhe ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave kulturore kombëtare, duke u bërë |

| | |
|---|---|
| | kontribues në formimin e profesionistëve të rinj në zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare.<br>Diploma që ofrohet nga ky program studimi është gjithashtu në përputhje me fushën e veprimtarisë. Qëllimi i programit të studimit është të pajisë studentët me informacion teorik dhe praktik që të bëhen kompetent në fushën e turizmit në mënyrë që të bëjnë karrierë në institucione publike, institucione private si dhe në fushën e akademisë.<br><br>*Ev.1.1 Statuti i UK.*<br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UK*<br>*Ev. I.26 Rrregullore e programit te studimit MTM* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Objektivat e këtij programi studimi janë përcaktuar në përputhje me misionin e UK që ka në fokus zhvillimin personal, intelektual dhe kreativ të studentit. Rregullorja e UK më konkretisht Neni 45-46 i që lidhet me programet e studimit të ciklit të parë bachelor paraqet përcaktimet rregulluese që janë të lidhura me programet e studimit, organizimin në kredite, formën e zhvillimit në përputhje me dokumentat strategjikë të IAL-së.<br><br>Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" është program i ciklit të parë të studimit me kohëzgjatje 3 vjeçare dhe 180 ECTS, në përputhje me aktet rregullatore të institucionit.<br><br>*Ev 1.1 Statuti i UK.*<br>*Ev 1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me rregulloren dhe objektivat e Departamentit të Marketing-Turizëm, në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Fakultetit të Ekonomisë.<br>Ky program studimi ka për qëllim të përgatisë specialist për tregun e punës shqiptar dhe ndërkombëtar, me qëllim të bërit karrierë në institucione publike dhe private, si dhe në fushën e akademisë. Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. |

| | |
|---|---|
| | *Ev 1.1 Statuti i UK.*<br>*Ev 1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT* |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë.<br>Rregullorja e programit të studimit është në përputhje me fushat didaktike dhe të kërkimit të programit nën njësinë kryesore.<br>Klasifikimi dhe kodifikimi i programit të studimit është bërë në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Programi i studimit të ciklit të parë bachelor është i organizuar në tre vite akademike me një total prej 180 kreditesh.<br><br>*Ev 1.1 Statuti i UK.*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se:*<br>*UK fron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat akademike kulturore kombëtare. UK ka përvojën dhe kapacitet në fushën akademike për përmbushjen e qëllimit të programit të studimit. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, si dhe fushën e disiplinave prioritare.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi | Mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit bazohet tek Statuti i UK, Rregullorja e Fakultetit, Rregullorja e Departamentit si dhe tek Rregullorja e programit të studimit, ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë. |

<table>
<tr><td>brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</td><td>Fakulteti i Ekonomisë ka ngritur marrëdhënie bashkëpunimi midis departamenteve për të siguruar ecuri efektive të programit të studimit nëpërmjet ndarjes së detyrave, përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës. Njësia bazë në bashkëpunim me njësinë kryesore shqyrtojnë dhe miratojnë planet mësimore, hartimim dhe rishikimi e programeve të lëndëve (silabuseve) bazuar në propozimet e nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e teksteve mësimore në lëndët e programit të studimit; si dhe ndjekja e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar me qëllim arritjen e cilësisë së mësimdhënies.<br><br>Ev 1.1 Statuti i UK.<br>Ev 1.2 Rregullorja e UK<br>Ev 1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UK<br>Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I<br>Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I<br>Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II<br>Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II<br>Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III<br>Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I<br>Ev 1.32 Rregullore e brendeshme e FE<br>Ev 1.26 Rregullore e programit te STUDIMIT MTM<br>Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</td><td rowspan="2">Aktualisht, institucioni ka shumë marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione dhe organizata të ndryshme për të përmirësuar cilësinë e programit të këtij studimi dhe për të ofruar mundësi të vlefshme për studentët dhe stafin akademik. Gjithashtu për të arritur objektiva e procesit mësimor institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me bizneset që operojnë në fushën e hotelerisë dhe mikpritjes, institucionet shtetërore, në kuadër të zhvillimit të praktikave dhe të aktiviteteve të përbashkëta.<br>Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme ka për qëllim kryesor përmirësimin e kurrikulës dhe zhvillimin e kërkimeve shkencore, si dhe mundësimin e zhvillimit të praktikave profesionale. Këto partneritete gjithashtu synojnë mundësinë për projekte të përbashkëta kërkimore që pasurojnë përvojën akademike dhe profesionale të të dyja palëve.<br>Nga ana tjetër, bashkëpunimi me kompani private fokusohet në sigurimin e praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit për studentët. Përmes këtyre marrëveshjeve, studentët fitojnë eksperiencë praktike dhe njohuri specifike të</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| praktikave të punës apo stazhit etj.<br>**Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | sektorit të turizmit, duke i përgatitur më mirë për tregun e punës. Nga ana tjetër, Organizatat jo-qeveritare (OJQ) luajnë një rol të rëndësishëm në angazhimin e studentëve në projekte sociale dhe mjedisore.<br>***GVJ rekomandon që raporti i realizuar nga njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të përfshijë shembuj konkretë të bashkëpunimeve dhe të specifikohen përfitimet konkrete që kanë rezultuar nga secili lloj bashkëpunimi duke u përmbajtur në statistika.***<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.39 Marreveshje bashkepunimi midis uk dhe univerisiteteve dhe institucioneve te tjera*<br>*Ev 1.40. Marreveshje bashkepunimi te FE*<br>*Tabela permbledhese (Tab. 5)* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se:*<br>*UK bashkëpunon në mënyrë aktive me sektorin e biznesit dhe institucione arsimore brenda dhe jashtë vendit. Institucioni ka vendosur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete dhe institucione kërkimore, kompani private, si dhe organizata jo-qeveritare (OJQ). Këto marrëveshje kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së kurikulës, zhvillimin e kërkimeve shkencore, dhe sigurimin e praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit për studentët. GVJ rekomandon që raporti i realizuar nga njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të përfshijë shembuj konkretë të bashkëpunimeve dhe të specifikohen përfitimet konkrete që kanë rezultuar nga secili lloj bashkëpunimi duke u përmbajtur në statistika.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** |
|---|

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit është i strukturuar në 3 vite studime, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër, ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UK si dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim.<br><br>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br><br>Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite.<br><br>Mbështetur në tabelat përmbledhëse të RVB, programi është organizuar si më poshtë vijon:<br><br>- 3 vite akademike/6 semestra;<br><br>- kredite për semester 30/ për vit akademik 60;<br><br>- numri i moduleve 36, përfshirë praktikën dhe diplomën apo detyrime të tjera përmbyllëse:<br><br>- Në vitin e parë zhvillohen 12 lëndë.<br>- Në vitin e dytë zhvillohen 13 lëndë.<br>- Në vitin e tretë zhvillohen 10 lëndë, si dhe mbrojtja e praktikës dhe detyrimeve përmbyllëse në semestrin e dytë.<br><br>- ngarkesa mësimore 4500 orë: 2125 orë në auditor; 2375 orë jashtë tij.<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e | Objektivat e programit të studimit përcaktojnë qartazi specialitetin e fushës së studimit si dhe aftësitë dhe kompetencat profesionale që studenti do të përftoj në përfundim të studimeve. Lëndët që e përbëjnë programin e studimit mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e |

| | |
|---|---|
| specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me fushën e turizmit. Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018, i ndryshuar, përsa i përket përmbajtjes sipas kategorive:<br>• Lëndë bazë (18%)<br>• Lëndë karakterizuese (55%)<br>• Lëndë plotësuese (13%)<br>• Lëndë ndërdisplinore (10%) dhe<br>• Detyrime përmbyllëse (4%)<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Mbështetur në VKM 41/2018, e ndryshuar, dhe në Rregulloren e Programit të studimit, programi është organizuar si më poshtë:<br>- Kategoria A - Lëndë Bazë-përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 32 ECTS ose 18%, në përputhje me *standardin (15-20%);*<br>- Kategoria B - Lëndë Karakterizuese-përgatitje për disiplinën shkencore, kategoria 99 ECTS ose 55%, në përputhje me *standardin (50-55%);*<br>- Kategoria C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese-nëndisiplina, profile dhe grup-lënde me zgjedhje 24 ECTS ose 13%, në përputhje me standardin *(12-15%);*<br>-Kategoria D - Lëndë plotësuese-gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 18 ECTS ose 10%, në përputhje me *standardin 10-15%);*<br>- Kategoria E - Detyrimet përmbyllëse, 7 ECTS ose 4%, në përputhje me *standartin (3-5%).*<br>Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, programi i studimit është organizuar si më poshtë vijon:<br>- 3 vite akademike/6 semestra;<br>- kredite për semester 30/ për vit akademik 60;<br>- numri i moduleve 36, përfshirë praktikën dhe diplomën;<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I* |

| | |
|---|---|
| | *Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Plani mësimor i programit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" ka të përcaktuara kreditet për realizimin e praktikës profesionale që përmban 3 kredite/ECTS dhe për detyrimet përmbyllëse/temën e diplomës që përmban 8 kredite/ECTS.<br><br>Me rëndësi specifike për programin e studimit është objektivi i forcimit të partneritetit me institucione të ndryshme publike dhe private në sektorë të ndryshëm me synim ofrimin e praktikave mësimore dhe orientimin e stydentëve drejt mundësive të punësimit pas përfundimit të studimeve.<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Tabelat permbledhese*<br>*Ev. 1.43 Udhezues praktike*<br>*Ev. 2.04 Udhezues per punimin e diplomes*<br>*Ev. 2.07 Modeli i diplomes dhe suplementit*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM* |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | **NA** |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën | Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" i ofruar nga Departamenti "Marketing-Turizëm" pranë UK, ka ngjashmëri me programet e ofruara nga IAL |

| | |
|---|---|
| fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | ndëtkombëtare ashtu sic edhe shpjegohet më qartë ne evidencën 2.15.<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Tabelat permbledhese*<br>*Ev. 2.04 Udhezues per punimin e diplomes*<br>*Ev. 2.07 Modeli i diplomes dhe suplementit*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM*<br>*Ev. 2.15 Programe te ngjashme nderkomb. me MTM* |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Veprimtaria akademike e UK zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi në kodifikimin e programeve të studimit. Për këtë program studimi IAL ka propozuar kodin 63BA0413S. |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i Studimit nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas apo të huaj. |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit është organizuar në përputhje të plotë me: Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/15, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar si me poshtë) "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", VKM nr. 879, datë 18.12.2019, ku përcaktohen elementet e një programi studimi: kreditet ECTS, kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, rezultatet e të nxënit dhe kompetencat profesionale, veprimtaritë formuese dhe komponentet mësimore, kategoritë e veprimtarive formuese, plani mësimor, syllabuset, etj. Kurrikula eshte ne perputhje me kriteret ligjore dhe programi përcakton një ngarkesë të përshtatshme në kredite për lëndë dhe module. Ky strukturim i qartë ndihmon* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *studentët të ndjekin progresin e tyre dhe të planifikojnë studimet e tyre në mënyrë efikase.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.<br><br>**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Departamenti i Marketing-Turizëm. përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, si dhe numrin e titujtve dhe gradave të stafit akademik. UK disponon akreditimin e fundit institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.02, datë 27.01.2023, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 26.01.2027. UK sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij katër fakultete emërtuar si vijon:<br><br>• Fakulteti i Ekonomisë;<br>• Fakulteti i Bujqësisë;<br>• Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë;<br>• Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane<br><br>GVJ konstaton se Departamenti i Marketing-Turizëm, në vitin 2023-2024, ka 11 personel akademik gjithsej, 9 pedagogë me kohë të plotë (PAE), 1 pedagogë me kohë të pjesshme (PAK), si dhe 1 personel ndihmës akademik.<br><br>Njësia bazë, përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, ku për vitin akademik 2023-2024 nga 11 PAE, 5 i përkasin kategorisë Prof. As. dhe 4 kanë gradën Dr. Ndërsa PAK i përktet kategorisë Msc.<br><br><br>*Ev.1.1 Statuti i UK*<br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.3 Plani strategjik i zhvillimit te UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT*<br>*Ev.3.2 Raport i veprimtarisë akademike të Departamentit* |

| | |
|---|---|
| | *Ev.Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Rregullorja e departamentit dhe Rregullorja e Programit ka të parashikuar koordinatorin e programit të studimit Bsc në “Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje”.<br>*Ev.1.1 Statuti i UK*<br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te STUDIMIT MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT*<br>*Ev. 2.09 Vendim i emerimit te koordinatorit te programit te studimit*<br>*Ev.3.2 Raport i veprimtarisë akademike të Departamentit*<br>*Ev.Tabelat permbledhese* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se: Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për ofrimin me sukses të këtij programi studimi. Departamenti përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, ku për vitin akademik 2023-2024 nga 11 PAE, 5 i përkasin kategorisë Prof. As. dhe 4 kanë gradën Dr. Ndërsa PAK i përktet kategorisë Msc.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje” si dhe vizitën e kryer në institucion, njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. IAL disponon të gjitha informacionet mbi programin e studimit, përfshirë lëndët, përmbajtjen e tyre, zhvillimin e lëndëve, ndarjen në semestra, orët mësimore, pedagogët që japin lëndët, etj. Këto janë të sanksionuara në të gjithë aktet rregullatore të Universitetit dhe lehtësisht të aksesueshme.<br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I* |

<table>
<tr><td></td><td>Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II<br>Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II<br>Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III<br>Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I<br>Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM<br>Tabelat permbledhese</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</td><td>Programi i studimit Bachelor në “Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje” i ofruar nga Departamenti i Ekonomisë është i strukturuar në 3 vite studimi, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër, ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UK si dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim.<br><br>Programi i studimit parashikon 2025 orë në auditor, nga të cilat:
<table>
<tr><th colspan="2">Bachelor në Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje</th></tr>
<tr><th>Format e mësimdhënies</th><th>Orët totale në auditor</th></tr>
<tr><td>Leksione</td><td>1056</td></tr>
<tr><td>Seminare</td><td>969</td></tr>
</table>
<br>Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM<br>Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I<br>Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I<br>Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II<br>Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II<br>Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III<br>Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I<br>Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM<br>Tabelat permbledhese</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</td><td>Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit bazohen në kriteret ligjore të përcaktuara nga MAS dhe udhëzimet që dalin për rregjistrimet në universitete çdo vit akademik.<br><br>Në Rregulloren e UK dhe të programit të studimit, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, tranferimit dhe ekuivalentimit.<br><br>Ev.3.2 Raport i veprimtarisë akademike të Departamentit<br>Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE<br>Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM<br>Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT<br>Ev. 5.01 Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Programi i studimit përmban</td><td>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit më drejtuesit, GVB, stafin akademik dhe Zyrën e Kurrikulave dhe Cilësisë, GVJ</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | evidentoi që programi i studimit dhe silabuset përmbajnë të gjithë elementët në përputhje me VKM 41/2018, e ndryshuar, ***por formati i silabusit nuk përputhet me VKM 41/2018.*** ***GVJ rekomandon që krahas elementëve të detajuar në lidhje, me objektivat e lëndëve, temat, javët e zhvillimit si dhe format e kontrollit brenda auditorit dhe jashtë tij, të përditësohet dhe unifikohet edhe formati i siabusit duke ju përmbajtur VKM 41/2018.***<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" është riorganizuar në vitin akademik 2021-2022 me qëllim përmirësimin e kurrikulës.<br><br>Përmbajtja e programit rishikohet vit pas viti duke u bazuar në rezultatet e studimit të tregut, rezultatet e pyetësorëve të studentëve si dhe takimeve të vazhdueshme me institucione te ndryshme dhe biznese me të cilat Institucioni ka lidhur edhe marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>Gjithsesi, duke qenë se ky program studimi akreditohet për herë të parë, IAL është në pritje të gjetje edhe të procesit të akreditimit, për të bërë ndryshimet e mundshme.<br><br>*Takimi me stafin akademik* |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se programi i studimit paraqet një burim të pasur informacioni, është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë por IAL duhet të bëjë përpjekje për të përshtatur dhe unifikuar silabuset në përputhje me aktet nënligjore nga ana formale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi II.4**

| **Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi i Studimit në mënyrën se si është i strukturuar përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve, I formon studentët me njohuri në fushën e menaxhimit të turizmit. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. Programi i studimit është i strukturuar për të mbuluar një gamë të gjerë të lëndëve, të cilat janë emërtuar në mënyrë që të reflektojnë qartë fokusin dhe përmbajtjen e tyre. Emërtimi i lëndëve është i tillë që tregon qartë objektivat e mësimit dhe fushat e specializimit që mbulojnë, duke ndihmuar studentët të kuptojnë rëndësinë dhe aplikimin e tyre praktike në sektorin e turizmit.<br>Programi përfshin një kombinim të leksioneve teorike dhe ushtrimeve praktike që sigurojnë një qasje të plotë ndaj tematikave të studiuara.<br>Praktika profesionale është e integruar në program për të siguruar që studentët të kenë mundësinë të aplikojnë njohuritë teorike në mjedise reale pune.<br>Struktura e programit dhe përmbajtja e lëndëve sigurojnë që studentët të jenë të përgatitur mirë për studime të mëtejshme në nivel master apo specializime të tjera profesionale.<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të | Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit u ofron studentëve mundësinë të marrin pjesë në një program që ndërthur teorinë dhe praktikën në fushën turizmit.<br>Struktura është e ndarë në semestra, ku secili semestër përmban një numër të caktuar të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrimeve |

| | |
|---|---|
| programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | përmbyllëse. Kurrikula e programit synon të balancojë lëndët dhe kreditet gjatë gjithë semestrave akademikë, me qëllim që vlerësimi në kredite dhe orë mësimore të jetë i drejtë dhe në proporcion me peshën dhe rëndësinë e çdo lënde.<br><br>Programi synon të zhvillojë aftësitë dhe njohuritë e studentëve, duke i pajisur ata me mjete dhe teknika moderne të menaxhimit dhe planifikimit strategjik. Këto objektiva janë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe kërkesat për profesionistë të kualifikuar në sektorin e turizmit.<br><br>Rezultatet e të nxënit janë të orientuara drejt sigurimit të një baze teorike dhe praktike në fushën e turizmit. Lëndët e përfshira në program synojnë të zhvillojnë aftësitë kritike të mendimit, aftësitë analitike, dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve. Studentët janë të inkurajuar të aplikojnë njohuritë e tyre në situata reale përmes praktikave profesionale.<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Programi është i strukturuar për të ofruar 180 kredite në total, të shpërndara në mënyrë të balancuar midis lëndëve teorike dhe praktikave profesionale. Lëndët janë të vlerësuara me kredite dhe orë mësimore që reflektojnë përpjekjen dhe kohën e nevojshme për të arritur objektivat e përcaktuara të mësimit. Kjo strukturë siguron që studentët të kenë një përvojë të plotë dhe të balancuar të mësimit, duke zhvilluar njohuri dhe aftësi të thelluara në fushat përkatëse.<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM* |

| | |
|---|---|
| | *Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Organizimi i kurrikulës sipas veprimtarive formuese në % të parashikuara nga ligji, si dhe raporti i orëve teorike, seminareve dhe orëve praktike, sigurojnë një përgatitje të mirë teorike dhe praktike të studentit për tregun e punës. Nga vlerësimi i programit të studimit dhe vizitës në IAL, GVJ vlerëson që ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Programi i studimit është i strukturuar për të përfshirë një kombinim të veprimtarive teorike dhe praktike. Leksionet, seminaret, dhe praktikat profesionale janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të sigurojnë një zhvillim të integruar të njohurive dhe aftësive të studentëve.<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Rishikimi i silabuseve dhe përditësimi i tyre me versionet më të fundit të teksteve akademike, që shërbejnë si literaturë bazë apo ndihmëse për lëndën, duhet të jetë një proces i vazhdueshëm nga Njësia Baze dhe Njësia Kryesore. ***Në shumicën e lëndëve literatura nuk është e 5 viteve të fundit, numri i titujve të librave duhet të pasurohet.***<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e | Nga vlerësimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson që programi i studimit është i strukturuar për të përfshirë një kombinim të balancuar të formimit teorik dhe praktik. Kjo strukturë siguron |

| | |
|---|---|
| dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, duke përgatitur studentët për tregun e punës dhe për studime të mëtejshme.<br>***GJV sugjeron inkurajimin e studentëve për të marrë pjesë në projekte praktike që lidhen drejtpërdrejt me fushën e tyre të studimit. Këto projekte mund të jenë të organizuara në bashkëpunim me kompani dhe organizata reale.***<br>***Këto masa do të sigurojnë që programi të përmbushë standardet dhe të përgatisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës.***<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 2.01 Plani mesimor i MTM*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Programi ofron përmbajtje që siguron mundësi të mira për punësim të studentëve pas përfundimit të studimeve, duke garantuar një ekspertizë të lartë në tregun e punës. Përveç kësaj, ky program u jep studentëve mundësinë për të vazhduar studimet e tyre në nivelin e Master apo specializime të tjera profesionale.<br>Përsa i përket punësimit, programi ofron njohuri dhe aftësi praktike që janë shumë të kërkuara në tregun e punës. Lëndët praktike dhe projektet e përfshira në program ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të marrë role udhëheqëse dhe menaxheriale në sektorin e turizmit.<br><br>*Ev 1.29 Kurrikula eprogramit te studimit MTM*<br>*Ev. 2.11 Ndryshimet ne planin mesimor te MTM*<br>*Ev. 1.28. Analiza e veprimtarise se QKA*<br>*Ev. 1.31. Module orientuse per tregun e punes*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Konkluzione** | *Programi ofron një përgatitje të gjerë teorike dhe praktike në sektorin e turizmit. Përsa i përket punësimit, programi ofron njohuri dhe aftësi praktike që janë shumë të kërkuara në tregun e punës. Për të përmirësuar me tej, GVJ rekomandon përshtatjen dhe unifikimin e formatit të silabusit dhe përditësimin e literaturës në pesë vitet e fundit me resurse të* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *reja që plotësojnë nevojat specifike të programit të studimit dhe inkurajimin e studentëve për të marrë pjesë në projekte praktike që lidhen drejtpërdrejt me fushën e tyre të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Bashkëpunimi i vazhdueshëm me aktorët e bizneseve dhe institucionet e ndryshme siguron një lidhje të qëndrueshme me tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës për studentët. përmbajtjes së programit të studimit Institucioni bazohet në rezultatet e Studimit të tregut, rezultatet e pyetësorëve nga studentët si dhe takimet e vazhdueshme me institucione/biznese me të cilat insitucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>*Ev. 1.39. Marreveshje bashkepunimi midis UK dhe univerisiteteve dhe institucioneve te tjera*<br>*Ev. 1.40. Marreveshje bashkepunimi te FE*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | UK ka krijuar një mjedis ku marrëdhënia ndërmjet institucionit, stafit akademik dhe studentëve është thelbësore. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e mësimdhënies, tregon përkushtimin e institucionit për të dëgjuar dhe për të integruar mendimet e tyre. IAL mban kontakt me studentët e diplomuar me qëllim njohjen e nevojave të tregut të punës si dhe shkëmbimin e eksperiencës me studentët aktual duke reflektuar nevojat e tregut dhe sfidat aktuale të fushës së turizmit. UK ka disa praktika të mira të bashkëpunimit me industrinë lokale në fushën e menaxhimit të turizmit të cilat duhet të monitorohen dhe të bëhen më të qëndrueshme, madje dhe në nivel departamenti, sa i përket prurjes së ideve që biznesi ka në rishikimin e vazhdueshëm të programit.<br><br>*Ev. 1.28. Analiza e veprimtarise se QKA*<br>*Ev. 1.39. Marreveshje bashkepunimi midis UK dhe univerisiteteve dhe institucioneve te tjera* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në | |

| | |
|---|---|
| fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | *Ev. 1.40. Marreveshje bashkepunimi te FE*<br>*Ev. 1.44. Struktura pergjegjese per sigurimin e cilesise*<br>*Ev. 3.01. Model pyetesori studentor*<br>*Tabelat permbledhese*<br><br>Panairi i Punës, konferencat studentore, praktikat mësimore dhe leksionet me të ftuar nga biznesi dhe institucionet përbëjnë një mundësi për ndërveprim, feedback dhe propozime konkrete.<br><br>Përfshirja e stafit e këtij programi studimi në shqyrtimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare është një vlerë e shtuar për programin e studimit, duke ofruar përvojë praktike dhe lidhje me turizmin, si dhe përmirësuar vazhdimisht kapacitetet njerëzore në funksion të programit.<br>Duke qenë anëtar i fondacionit "La fondation pour la formation Hoteliere", ka bërë të mundur jo vetem përfshirjen e stafit në konferenca të ndryshme dhe trajnime në fushën e turizmit, por edhe përfshirjen e stafit në e-librarinë e Instituttit të Mikpritjes, e cila ndihmon ne përditësimin e programit, ***por GVJ e shikon të rëndësishëm përditësimin e vazhdueshëm të literaturës fizike në pesë vitet e fundit me resurse të reja që plotësojnë nevojat specifike të programit të studimit.***<br><br>Në nivel institucioni, bazuar në elementët e ofruar në kuadër të paketës së cilësisë, bëhen pyetësorë për vlerësimin e programit dhe të mësimdhënies, rezultatet e të cilave shërbejnë për të diskutuar dhe marrë vendime të mëtejshme.<br><br>*Ev. 1.27. Studim tregu*<br>*Ev. 1.39. Marreveshje bashkepunimi midis UK dhe univerisiteteve dhe institucioneve te tjera*<br>*Ev. 1.40. Marreveshje bashkepunimi te FE*<br>*Ev. 5.07 Aktiviteti kerkimor-shkencor i DMT*<br>*Tabelat permbledhese* |
| **Konkluzione** | *UK dhe me konkretisht Departamenti nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, duke pasur marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione të ndryshme në fushën e turizmit, si dhe pjesëmarrje të konsiderueshme në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, për hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me cilesi të objektivave të tyre. Duke qenë anëtar i fondacionit "La fondation pour la formation Hoteliere", ka* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *bërë të mundur përfshirjen e stafit në konferenca të ndryshme dhe trajnime në fushën e turizmit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL, për programin e studimit në shqyrtim, vërehet se UK ka përfshirë të gjitha format e mësimdhënies e mësimnxënies siç janë janë leksionet, seminaret, detyrat e kursit, praktikat profesionale, orët e hapura, të paraqitura në planin mësimor dhe në syllabuset përkatëse. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur si dhe nga takimet në institucion, vërehet se janë parashikuar dhe leksionet e hapura. Përveç aftësimit teorik UK ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme me aktorë jashtë IAL për aftësim praktik në institucione rajonale që kanë bujqësinë dhe ushqimin në fokus të tyre.<br><br>*Ev. 1.33. Leksione te hapur*<br>*Ev. 1.41. Aktivitete te DMT*<br>*Ev. 2.01 Plani mesimor i MTM* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Personeli akademik u përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar jo vetëm leksione, por edhe aktivitete alternative akademike si leksione të hapura, vizita në studio apo kompani etj. IAL ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme me aktorë jashtë institucionit për aftësim praktik që është e rëndësishme për vetë karakteristikën e programit të studimit.<br><br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II* |

| | |
|---|---|
| | *Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 1.33. Leksione te hapur*<br>*Ev. 1.41. Aktivitete te DMT*<br>*Ev. 2.01 Plani mesimor i MTM* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL dhe nga diskutimet me stafin akademik vërehet se stafi akademik inkurajohet dhe mbështetet të zhvillohet dhe përmirësojë cilësinë e mësimdhënies duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme dhe projekte ndërkombëtare që do çojnë në përmirësimin e kurrikulës dhe teknikave të mësimdhënies. Stafi nxitet të marrë pjesë në mobilitete mësimdhënieje në institucione ndërkombëtare në bazë të marrëveshjeve institucionale të bashkëpunimit.<br>Këto aktivite, kanë ndikuar në rritjen profesionale të stafit akademik, duke dhënë një impakt pozitiv në implementimin e standardeve evropiane të mësimdhënies dhe sidomos nxitjen e të nxënit gjatë të vazhduar, për përshtatjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e kurrikulave në varësi të nevojave të tregut të punës.<br><br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev. 1.33. Leksione te hapura*<br>*Ev. 1.39. Marreveshje bashkepunimi midis UK dhe univerisiteteve dhe institucioneve te tjera*<br>*Ev. 1.40. Marreveshje bashkepunimi te FE*<br>*Ev. 1.41. Aktivitete te DMT*<br>*Ev. 2.01 Plani mesimor i MTM*<br>*Ev. 2.10 CV e stafit akademik te MTM*<br>*Ev. 5.07 Aktiviteti kerkimor-shkencor i DMT* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në | Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita e kryer në IAL, vërehet se UK ka hartuar udhëzues të posaçëm dhe ka zhvilluar mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies.<br>Institucioni inkurajon ndërveprimin e pedagogut dhe studentit edhe jashtë orarit të lëndëve gjë që i vjen në ndihmë studentit, sidomos për punimin e projekteve të zhvilluara në mënyrë të |

| | |
|---|---|
| qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.<br><br>**Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.<br><br>**Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të | pavarur, ku ata mund të komunikojnë dhe të shkëmbejnë materiale me pedagogun.<br>Hartimi i udhëzuesve dhe ngritja e strukturave përkatëse është rregulluar nëpërmjet Statutit të institucionit, Rregullores së institucionit, Rregullores së Senatit Akademik, Udhëzimit për miratimin e teksteve mësimore në nivel të Njësisë Bazë, si dhe Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, reflektuar në Nenin 3, pika 2 për ngritjen e strukturës përkatëse si dhe në Nenin 6, pika 8, për monitorimin e cilësisë.<br><br>*Ev.1.1 Statuti i UK*<br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev. 1.11 Rregullore e Senatit Akademik*<br>*Ev. 1.12 Udhezim per miratimin e teksteve mesimore ne nivel njesie baze*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev. 1.44. Struktura pergjegjese per sigurimin e cilesise*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT*<br><br>Monitorimi i cliësisë së mësimdhënies pasqyrohet në raportet e vlerësimit të kryer nga NJSBC-ja. Gjithashtu, monitorimi i cilësisë është rregulluar nëpërmjet Manualit të Cilësisë i cili përcakton hapat, detyrat dhe strukturat për garantimin e cilësisë në mësimdhënie. Studentët përfshihen në këtë proces nëpërmjet pyetësorëve. Nga vlerësimi i studentëve, në pyetësorët mbi procesin mësimor, rezulton se stafi akademik është në nivelin e pritshmërive të tyre, si në aspektin e përgatitjes mësimore edhe në mënyrën e komunikimit.<br><br>Përfshirja e studentëve në monitorim kryhet edhe nëpërmjet përfaqësimit të një studenti në NJSBC. Publikimi i të dhënave të monitorimit të cilësisë dhe aspekteve të tjera në raport me studentët dhe jo vetëm është rregulluar nëpërmjet Manualit te sistemit elektronik Pitagora. Gjithashtu, sipas stafit të UK që morën pjesë në takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion të dhënat e nxjerra nga aktivitetet monitoruese për cilësinë por jo vetëm publikohen në faqen zyrtare të institucionit.<br><br>Strukturat të ngritura në nivel Institucioni ndikojnë në përmirësimin e mësimdhënies, përmes zhvillimit të mësimit në mënyrë interaktive, nxitjes së debateve, mendimit kritik, rasteve studimore, punës në grup për përgatitjen dhe prezantimin e punimeve të kursit. Strukturat e ngritura në |

| | |
|---|---|
| Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.<br><br>**Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.<br><br>**Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.<br><br>**Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.<br><br>**Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e | vlerësimit si dhe organizimi i tyre. Në nenin 103, përcaktohet gjithashtu mundësia dhe procedura e studentit për ankimimin e vlerësimit.<br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT*<br><br>Rregullorja e njësisë bazë parashikon shpalljen e komisioneve të provimit një javë përpara provimit. Rolin kryesor në përgatitjen e formave dhe procesit të vlerësimit e ka titullari i lëndës. Përgjithësisht vlerësimet e dijeve dhe njohurive të studentëve janë të vlerësuara nga titullari përgjegjës i lëndës, dhe në rastin e provimit me gojë mund të bëhet nga titullari apo grup pedagogësh. Studenti njihet me mënyrën e vlerësimit të dijes përmes syllabusit që i jepet dhe shpjegohen orët e para të mësimit. Gjithashtu, studenti njihet përmes syllabusit edhe me format e testimit, provimit dhe dorëzimit të projektit në varësi të lëndës, si dhe me kriteret e vlerësimit.<br>Testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme, ku vlerësohet jo vetëm rezultati në provimet përfundimtare apo në dorëzime detyrash/projekte, por edhe nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, dhe pjesëmarrja aktive në klasë në diskutime apo punë praktike. Studentet dhe pedagoget konfimojne këto mënyra testimi.<br><br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br><br><br>Departamenti, përgjegjës për këtë program studimi, çdo vit akademik merr në shqyrtim syllabuset e lëndëve, ku përfshihen edhe format e mësimdhënies. Në këtë proces diskutohen edhe sugjerimet e studentëve.<br>Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, përmes përgjigjeve të dhëna prej tyre në pyetësorët e shpërndarë nga SKVI mbi cilësinë e mësimdhënies. Gjithashtu, Departamenti përpilon analliza |

| | |
|---|---|
| mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | funksion të përmirësimit të cilësisë marrin opinionet e studentëve.<br><br>UK u siguron personelit akademik mundësinë për pjesëmarrje në mobilitete në universitete të huaja në kuadër të programeve Erasmus+<br><br><br>*Ev. 1.44. Struktura pergjegjese per sigurimin e cilesise*<br>*Ev.1.1 Statuti i UK*<br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.1.5 Rregullore e drejtorisë së kurrikulave dhe Vleresimit Institucional*<br>*Ev.1.6 Marreveshje RASH per sistemin elektronik Pitagora*<br>*Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK*<br>*Ev. 3.01 Model pyetesori studentor*<br>*Ev. 3.02 Raporte vjetore te veprimtarise DMT* |
| **Konkluzione** | *GVJ evidendon se Programi i studimit përmban forma të shumëllojshme të*<br>*mësimdhënies dhe mësimxënies mbështetur në aktet rregullatore të institucionit dhe në funksion të arritjes së synimeve të programit.*<br>*Bashkëpunimet e lindura nga projektet ndërkombëtare, pjesëmarrja aktive e stafit në mobilitete si dhe eksperienca e konsiderueshme e stafit të angazhuar në këtë program studimi bën të mundur që IAL të garantojë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e | GVJ vlerëson që testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik nëpërmjet formave të ndryshme të përcaktuara në rregulloren e institucionit. Format kryesore të kontrollit të vlerësimit të njohurive janë testimet, esetë, prezantimet, projektet si dhe praktika profesionale. Në rregulloren e institucionit përcaktohen procedurat që ndiqen për realizimin e vlerësimit të studentëve ku parashikohen dhe format e ndryshme të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | vjetore ku pasqyron arritjet dhe problematikat e hasura në procesin e mësimdhënies.<br>Perosneli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka si synim përcjelljen e informacionit te studentët në mënyrë të kuptueshme dhe inovative me qëllim rezultatet e të nxënit. Stafi akademik gjatë prezantimit të leksioneve ka parashikuar edhe hapësirë për studentët në mënyrë që të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre. Projektet e studentëve nxisin punën e pavarur të studentit, si dhe i jep mundësinë të komunikojë me pedagoget në rast të paqartësive dhe pyetjeve të tyre.<br>Pedagogët i plotësojnë leksionet tradicionale me metoda të tjera si orë praktike diskutime në klasë, detyra dhe projekte sfiduese individuale dhe në grupe, prezantime etj.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev.1.16 Manuali i cilësisë UK*<br>*Ev. 3.01 Model pyetesori studentor*<br>*Ev. 3.02 Raporte vjetore te veprimtarise DMT* | | | |
| **Konkluzione** | *Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive duke gërshetuar punën kërkimore gjatë kursit me provën përfundimtare.*<br>*Sistemi i vlerësimit është qartësisht i shprehur ne syllabusin e lëndës. Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, përmes përgjigjeve të dhëna prej tyre në pyetësorët e shpërndarë nga SKVI mbi cilësinë e mësimdhënies* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive | Bazuar në DVV, syllabuset e lëndëve, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, |

| | |
|---|---|
| profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare dhe laboratorë, detyrave të kursit etj. sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në pikë dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës. Kjo mënyrë vlerësimi krijon mundësinë për të vlerësuar progresin e arritur nga studentët dhe i mundëson atyre të evidentojnë mangësitë e paraqitura.<br>Gjithashtu, Rregullorja e Departamentit përcakton parimet e kritereve të vlerësimit për lëndën, si edhe tabelën e vlerësimit të notave brenda kornizave kohore të dedikuara sipas karakteristikave të lëndës.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I* |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Me qëllim rritjen e transparencës, provimet zhvillohen si në formatin e printuar ashtu edhe në atë elektronik me anë të programit dixhital Pitagora. Institucioni ka vënë në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike të vlerësimit të cilat sigurojnë aksesin e studentëve në informacionin e nevojshëm siç janë notat, frekuentimi etj., por edhe sigurojnë transparencën e vlerësimit dhe shmangin format e mundshme të abuzimit.<br>Një tjetër formë për vlerësimin e njohurive është edhe përdorimi i CleanScore, mëllim mundësimin e provimeve të automatizuara.<br><br>*Ev.1.1 Statuti i UK*<br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev.1.20 Rregullore e Bordit të Amdinistrimit.* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Studenti njihet me syllabusin e secilës lëndë nga pedagogu përkatës në fillim të semestrit. Në të janë të përcaktuar edhe mënyrat e vlerësimit të njohurive.<br>Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e silabuseve përkatës për çdo lëndë, dhe rregulloren e IAL dhe zhvillohet duke marrë parasysh vlerësimet e pjesshme dhe ato përfundimtare të secilit element të testimit të lëndës. |

| | |
|---|---|
| | Komisionet e provimeve të përbërë nga dy pedagogë dhe titullari i lëndës, ngrihen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit në përputhje me Statutin e Universitetit dhe rregulloren e provimeve.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret institucionale. Vlerësimi i studentëve përpilohet nga sistemi Pitagora dhe studentëve i lind e drejta të ankimojnë rezultatin e provimit duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në aktet rregullatore.<br>Studentët marrin feedback gjatë gjithë vitit duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen, lidhur me përparimin e tyre përsa i takon përputhshmërisë së performancës së tyre akademike me kërkesat e lëndës<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore brendeshme e DMT* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | UK përcakton në "Kodin e Etikës" dispozitat për shkeljet disiplinore, siç mund të jetë kopja, rastet e plagjaturës apo format e tjera të mashtrimit, rastet e të cilave trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Të gjithë punimet e studentëve sic janë detyrat e kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, i nënshtrohen sistemit antiplagjiaturë. Plagjiatura sqarohet gjerësisht nga pedagogët për studentët gjatë zhvillimit të lëndës, në mënyrë që studentët të informohen si duhet se çfarë përbën plagjaturë dhe si mund të bëhen citimet e materialeve shkencore. Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren dhe procedurat e provimit dhe kodin e etikës për të mirë organizuar procesin e vlerësimit të dijeve si dhe kriteret e mbikëqyrjes dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Së bashku me specialistin IT krijohet dritarja përkatëse ku studentët mund të dorëzojnë detyrat e përfunduara. Elementë të Kodit të Etikës citohen edhe në silabuset e secilës prej lëndëve që përbëjne programin e studimit.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK* |

| | |
|---|---|
| | *Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora*<br>*Ev.1.19 Kodi i Etikës*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev.2.04 Udhezues per punimin e diplomes* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Ekzistojnë forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve duke patur parasysh objektivat didaktike të lëndës me një sistem prej 10 notash, ndërsa nota më e ulët kaluese është 5. Këto forma përfshijnë aftësitë analitike të studentëve, ato prezantuese, kapacitetet për të sintetizuar materialin që i vihet në dispozicion dhe promovuar një këndveshtrim kritik.<br>Rregullorja e UK përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore, jo më shumë se 8 ditë nga data e provimit përfundimtar - pasi më parë sekretaria ka informuar pedagogët lidhur me këto data, që në fillim të vitit akademik. Ky informacion është i pasqyruar në kalendarin akademik, i cili publikohet edhe në faqen e internetit të universitetit.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.<br>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Studentët njihen me notën përpara se kjo të dorëzohet në sekretari dhe mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me vlerësimin si edhe të kërkojnë të takohen me pedagogun për të marrë një arsyetim lidhur vlerësimin me notë. Studentët kanë të drejtën e ankimit për notën brenda 8 ditëve nga marrja e përgjigjes së provimit pranë pedagogut të lëndës, i cili shqyrton nëse ka patur ndonjë gabim në korrigjimin e provimit, dhe në rast se studenti nuk bindet për argumetimin ka të drejtë të ankohet pranë dekanatit që ngre një komision të posaçem vlerësimi. Studentët ndjekin një procedurë te veçantë për ankimimet në të gjitha nivelet dhe për të gjitha strukturat duke përfshirë si anën akademike ashtu edhe atë logjistike apo administrative.<br>Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën fillimisht me pedagogun e lëndës dhe nëse pedagogu nuk e gjykon me vend të rishikojë notën, atëherë ankimimi i drejtohet Dekanit të Fakultetit.<br>Procedurat janë transparente dhe mund të ndiqen në çdo hap si nga studenti ashtu edhe nga sekretaria, e cila dokumenton dhe |

| | |
|---|---|
| | arkivon çdo hap duke përfshirë edhe raportin përfundimtar të aprovuar nga dekanati.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT* |
| **Konkluzione** | *UK ka të përcaktuar në aktet rregullatore të gjithë procedurat që duhet të ndiqen si nga stafi akademik, ashtu edhe nga studentët në kuadër të transparencës të vlerësimit të dijeve.*<br>*Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nepermjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara çdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë teorike në fushën e turizmit, praktikën mësimore si dhe përmbyllet me punimin e diplomës.<br>Programi i studimit i ofron studentëve njohuri si të zhvillojnë aftësitë kritike brenda programit të studimit. Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse. Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Stafi akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Kjo kurrikul parapërgatit studentët për thellimin e studimeve në ciklin master.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.1.6.1 Manual i sistemit elektronik Pitagora*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM* |

| | |
|---|---|
| | *Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev.2.1 Plani mesimor i MTM* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Programi i studimit garanton zhvillimin e veçantë në fushën e menaxhimit të turizmit si dhe aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit.<br>Nga vizita në institucion me stafin akademik dhe studentët, si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar pranë ASCAL u konstatua se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve. Në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet kuizeve, rasteve studimore, ditëve të hapura, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve.<br><br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI II*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI III*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 2021-2022 VITI I*<br>*Ev.2.1 Plani mesimor i MTM* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Bazuar në dokumentet e dosjes së vetëvlerësimit dhe në veçanti rregullores së programit të studimit dhe atyre institucionale, konstatohet se në fund të çdo semestri, kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lëndë, analizohen dhe rishikohen. Kujdes i veçantë u kushtohet lëndëve që janë në vijimësi të lëndëve të tjera në semestrat pasardhës dhe mbahet komunikim midis lektorëve të lëndëve që janë të ndërlidhura. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT* |

| | |
|---|---|
| | *Ev 1.30 Programe lendore 22-23 VITI I*<br>*Ev.2.1 Plani mesimor i MTM* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Për të analizuar kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde, GVJ vëren se institucioni ka rregullore dhe mekanizma vlerësimi të cilat nxjerrin në pah problematikat e ndryshme si dhe për të orientuar studentët për zbatimin e tyre.<br>Në të njëjtën kohë, edhe rregulloret e institucionit dhe programit parashikojnë këto aspekte të vlerësimit të studentëve. Njësia bazë dhe stafi akademik analizon në mënyrë periodike ecurinë e punës dhe rregullon procesin e vlerësimit për provimet finale të moduleve. Në analizën periodike kërkohet nga pedagogu i çdo lënde pasqyrim i objektivave të arritura dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Nga diskutimet me stafin akademik dhe studentë gjatë vizitës në institucion u shpreh se stafi akademik/pedagogu pas përfundimit të çdo lënde realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara dhe e orienton studentin drejt provimit përfundimtar.<br>Gjithashtu, përfshirja e praktikës profesionale në kurrikulën e programit, i mundëson studentëve njohuri praktike në profesionin e tyre dhe i përgatit ata për tregun e punës. Institucioni i jep mundësine studentëve të jenë pjesë e disa konferencave studentore, projekte në menyrë qe te rrisin dhe mundësine e shkëmbimeve studentore. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Personeli akademik është i organizuar në vazhdimësi në veprimtari shkencore jashtë programit të studimit dhe për këtë qëllim organizon orë të hapura me guest-lectures por edhe inkurajon studentët që të marrin pjesë në seminaret akademike të organizuara nga UN apo IAL të tjera duke paraqitur edhe punimet e përgatitura nga studentët në bashkëpunim edhe me pedagoget.<br><br>*Ev. 1.33. Leksione te hapura*<br>*Ev. 1.39. Marreveshje bashkepunimi midis UK dhe univerisiteteve dhe institucioneve te tjera*<br>*Ev. 1.40. Marreveshje bashkepunimi te FE*<br>*Ev. 1.41. Aktivitete te DMT*<br>*Ev. 2.01 Plani mesimor i MTM* |

| | |
|---|---|
| | *Ev. 2.10 CV e stafit akademik te MTM*<br>*Ev. 5.07 Aktiviteti kerkimor-shkencor i DMT* |
| **Konkluzione** | *Njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi të ofertës akademike duke realizuar në mënyrë të vazhduar takime, seminare, workshop-e, në kuadër të bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës. Personeli akademik nxitet të përdorë metoda inovative të mësimdhënies të cilat nxisin tek studentët mendimin kritik dhe aftësimin praktik në përshtatje me kërkesat dhe objektivat formues të programit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit parashikohet që njësia bazë të ndjekë një procedurë të posaçme për studentët që japin provimin final ose mbrojnë diplomën. Anëtarët e stafit akademik depozitojnë pranë përgjegjësit të njësisë bazë një grup pyetjesh (fond pyetjesh) për çdo lëndë/modul të tyre me qëllim që studentët të orientohen paraprakisht në lidhje me literaturën që duket të lexojnë për t'u përgatitur për provimin final.<br>Ndërkohë, procedura më specifike realizimin e punimit të diplomës e më pas në mbrojtjen e saj, gjenden në Udhëzuesin e Diplomimës, informacion që i vihet në dispozicion të gjithë studentëve para fillimit të procedurave të diplomimit.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev.2.04 Udhezues per punimin e diplomes* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, | Gjatë takimit me studentët u evidentua se ata asistoheshin nga personeli akademik në takime informuese apo edhe me komunikime elektronike, rreth procedurave të zhvillimit të praktikave profesionale si dhe ato që duhen ndjekur për hartimin e punimit të diplomës. |

| | |
|---|---|
| udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Ky informacion përfshin si detyrimet akademike që studentët kanë për përmbylljen e programit.<br>Tema dhe udhëheqësit miratohen nga Departamenti pas konsultimeve me studentët.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev.2.04 Udhezues per punimin e diplomes* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit, parashikohet që njësia bazë të ndjekë një procedurë të posaçme për studentët që japin provimin final ose mbrojnë diplomën. Anëtarët e stafit akademik depozitojnë pranë përgjegjësit të njësisë bazë një grup pyetjesh (fond pyetjesh) përçdo lëndë/modul të tyre me qëllim që studentët të orientohen paraprakisht në lidhje me literaturën që duket të lexojnë për t'u përgatitur për provimin final.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev.2.04 Udhezues per punimin e diplomes* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i | Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik.<br><br>Studenti punon në temën e dizertacionit duke u konsultuar dhe orientuar në çdo hap nga udhëheqësi duke filluar nga gërshetimi i metodologjisë së dizertacionit me kerkimin shkencor, rezultatet, perpunimin e tyre dhe hartimin e konluzioneve. Studenti paraqet drafte të punës dhe merr vazhdimisht feedback nga udhëheqësi, i cili duhet të japë aprovimin në mënyrë që studenti të mund të dorëzojë diplomen. |

| | |
|---|---|
| plotë për t'u paraqitur para komisionit. | GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, origjinalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT*<br>*Ev 1.30 Programe lendore 23-24 VITI I*<br>*Ev.2.04 Udhezues per punimin e diplomes* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Udhëheqesi asiston studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të dizertacionit. Përvec vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda institucionit për hartimin e dizertacionit, por edhe jashtë tij. Për këtë, udhëheqësi ofron gjithashtu nëpërmjet kontakteve personale edhe mundësinë që studenti të marrë ekspertizën dhe ndihmën e nevojshme me ekspertë jashtë institucionit kur kjo është e nevojshme.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev.2.3 Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Agrobiznesit"*<br>*Ev.2.5 Rregullore e programit të studimit*<br>*Ev. Takimi me stafin e projekteve në IAL* |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Diplomimi i studentëve të këtij programi studimi realizohet me mbrojtjen e temës së diplomës ose me provim përfundimtar dhe vlerësohet me notë me sistem vlerësim shqiptar me dhjetë nota. Vlerësimi përfundimtar është një mesatare e vlerësimeve të pavarura të anëtarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidati.<br>Tema e diplomës dhe provimi vlerësohen nga komisioni prej jo me pak se dy anëtarësh i ngritur dhe aprovuar për këtë qëllim sipas rregullores së departamentit/programit të studimit/ rregullores se UK me një sistem notash nga 4-10 – dhe bërë kalimin nga sistemi i pikëve tek ai i notave. Komisioni jep feedback mbi vlerësimin e bërë me shkrim. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i notës 5.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM* |

| | |
|---|---|
| | *Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 kredite ECTS, zyrat administrative përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma lëshohet vetëm një herë dhe regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Në sekretarinë mësimore dhe në atë të njësisë kryesore, ruhet i gjithë dokumentacioni për çdo vit akademik dhe studenti, edhe mbasi është diplomuar, mund të kërkojë dhe të marri kopje të dokumentacioneve që kanë qenë në fuqi në periudhën kur ka qenë student pranë këtij institucioni.<br><br>*Ev.1.2 Rregullorja e UK*<br>*Ev 1.32. Rregullore e brendeshme e FE*<br>*Ev 1.26 Rregullore e programit te studimit MTM*<br>*Ev 1.45. Rregullore e brendeshme e DMT*<br>*Ev 2.07 Modeli i diplomes dhe suplementit* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstatojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizim i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë.<br>Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e rregjistrit themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. Kjo sekretari ngarkohet edhe me mbajtjen e kartelës së studentit ku pasqyrohen kreditet e akumuluara dhe aktiviteti akademik. Dosjet personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin qendror të universitetit duke respektuar normat ne fuqi për privatësinë por edhe rregulloren e këtij arkivi.<br><br>*Ev.1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit TIK* |
| **Konkluzione** | *IAL ka të përcaktuar qartë procedurat e mbylljes së studimeve, mbrojtjen e diplomës apo të provimit të formimit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Institucioni administron në përputhje me legjislacionin në fuqi dokumentacionin e studentit që nga momenti i regjstrimit në program, deri në momentin e diplomimit. UK pajis studentët me diplomën sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj, ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga udhëheqësi i tezës së diplomës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | UNIKO, menaxhon dhe administron të dhënat e personelit akademik, ndihmës mësimor, kërkues shkencor dhe administrativ nëpërmjet Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore si dhe Sektorit të Informimit dhe Promocionit, të cilat bazohen në rregulloret përkatëse për funksionimin e gjithë procesit. Baza e të dhënave përfshin gjithashtu dokumentacionin lidhur me organikën e FE, CV-të e personelit akademik, si dhe të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ që kontribuon në realizimin e programeve të studimit.<br>Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, CV-të e Personelit akademik, vizitat dhe takimet e GVJ-së në institucion, rezulton se stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi, është në nivelin e duhur të kualifikimi me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie. Vihet re mungesa e Personelit akademik me titull Profesor Doktor. |

| | |
|---|---|
| | Për vitin akademik 2023-2024, stafi përgjegjës për këtë program studimi përbëhej nga 29 PEA (13 Prof. As., 14 Dr., 2 Msc.) dhe 0 PAK. Për vitin akademik 2022-2023, stafi përgjegjës për këtë program studimi përbëhej nga 28 PEA (11 Prof. As., 12 Dr., 5 Msc.) dhe 4 PAK (4 Msc). Ndërsa për vitin akademik 2021-2022, stafi përgjegjës për këtë program studimi përbëhej nga 28 PEA (11 Prof. As., 12 Dr., 5 Msc.) dhe 4 PAK (4 Msc).<br><br>Stafi i përfshirë në mësidhënie në programin Bachelor "Menaxhim Turizmi dhe Mikpritje" ka përfaqësues nga breza të ndryshëm, gjë që ndikon në krijimin e një mjedisi stimulus dhe përcjelljen graduale të përvojave nga një brez në tjetrin. Departamenti ndjek politikë gjithëpërfshirëse për të angazhuar stafin në projekte të ndryshme. Gjithashtu, stafi nxitet për të marrë pjesë në trajnime e workshop-e, si dhe për kryerjen e mobiliteteve në Universitete dhe Departamente partnere jashtë Shqipërisë.<br><br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO*<br>*Evidenca 1.4. Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore;*<br>*Aneksi II.10. CV e Stafit Akademik të MTM;*<br>*Aneksi I.37. Të dhëna për Personelin Akademik të MTM.*<br>*Evidenca 1.13. Udhëzim për rekrutimin e stafit akademik;*<br>*Aneksi IV.02. Format i shpalljes së vendit vakant;*<br>*Aneksi IV.03. Format i vlerësimit të kandidatëve;*<br>*Aneksi IV.04. Modeli i Kontratës individuale të punës;*<br>*Aneksi IV.05. Format Urdhër Emërimi;*<br>*Aneksi IV.06. Kriteret e pranimit të Personelit Akademik me kohë të pjesshme.* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Stafi akademik që është i angazhuar me kohë të plotë në programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi dhe Mikpritje", ka ngarkesën mësimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Raporti PAE/PAK është në përputhje me ligjet, udhëzimet dhe vkm-të në fuqi, ku PAE përbën mbulon mbi 70 % të ngarkesës.<br>Në shpërndarjen e ngarkesës së PAE-së janë pasur parasysh dhe janë respektuar si ngarkesat në auditor ashtu edhe ato jashtë auditorit, në bazë të gradës shkencore, titullit akademik apo pozicionit të secilit anëtar. Personeli akademik përdor metoda të reja të mësimdhënies dhe bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së tij dhe ofrimin e një eksperience sa më të mirë për studentët. |

| | |
|---|---|
| | Personeli efektiv, në takimin me GVJ, u shpreh se mbingarkesa që kanë në këtë program studimi është e përballueshme prej tyre.<br><br>*Takimi i GVJ-së me Stafin Akademik;*<br>*RVB;*<br>*Aneksi IV.09. Ngarkesa mësimore e Stafit të Programit MTM.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Institucioni dhe Departamenti garantojnë qendrueshmërinë e Stafit Akademik të përfshirë në programin e studimit Bachelor "Menaxhim Turizmi dhe Mikpritjeje". Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe diskutimi me Personelin Akademik Efektiv të programit, vihet re qëndrueshmëria e tyre në punë, për një periudhë të gjatë dhe jo vetëm gjatë akreditimit.<br>Stafi akademik i punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme pajisen me kontratë punësimi, në momentin e rekrutimit të tyre nga Institucioni. ***Në dokumentacion mungojnë kontratat e stafit akademik efektiv ose me kontratë, por është vetëm modeli i kontratës i paplotësuar. Institucioni mbulon detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.***<br><br>*Vizita në Institucion e GVJ, diskutimi me Stafin akademik të programit të studimit Bachelor MTM;*<br>*Aneksi II.10. CV e Stafit Akademik të MTM;*<br>*Aneksi IV.09. Ngarkesa mësimore e stafit të programit MTM;*<br>*Aneksi IV.06. Kriteret e pranimit të Personelit Akademik me kohë të pjesshme.*<br>*Evidenca 1.13. Udhëzim për rekrutimin e stafit akademik.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Pas konsultimit me RVB-në, dokumentet mbështetëse dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se në UNIKO ndiqet procedurë rekrutimi e hapur dhe transparente, që ofron mundësi të barabarta për konkurrim, paanshmëri dhe respekton Ligjet, VKM-të dhe Kodin e Punës në fuqi. Procedura e përdorur është e përshkruar në Rregulloren e UNIKO-s, ku përshkruhen gjithashtu edhe kriteret e përgjithshme. Në rregullore përcaktohet se kriteret e veçanta përcaktohen nga Njësia Bazë, e cila i përshtat ato sipas nevojave dhe specifikave të programit të studimit dhe nevojave të saj. Më pas kriteret përcillen në Rektorat, ku edhe miratohen.<br>Sipas kritereve të paraqitura në formatin e vlerësimit si dhe pas takimeve të GVJ-së në Institucion, është vënë re se kriteri i specialitetit të diplomës universitare, përfunimi i studimeve doktorale dhe titujt akademik, kanë prioritet, për të garantuar cilësinë e personelit akademik që do të përzgjidhet. Gjithashtu, |

| | |
|---|---|
| | përcaktohen kritere specifike në rast se dy kandidatë kanë arritur të njëjtin rezultat, duke i dhënë përparësi atij që ka diplomë nga universitete të njohura të vendeve të OECD.<br>UNIKO ndjek gjithashtu procedurën e duhur pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, duke nënshkruar kontratën individuale të punës midis tij dhe Rektorit, si përfaqësues i autoritetit të UNIKO-s, dhe kandidatët fillojnë punën pas nxjerrjes së urdhërit të emërimit nga Rektori.<br>Për rekrutimin e pedagogëve me kohë të pjesshme, procedura fillon me një mbledhje në nivel departamenti, ku diskutohet shpërndarja e ngarkesës mësimore dhe përcaktohen kriteret specifike të cilat mbështeten në specialitetin dhe kualifikimet e kandidatëve.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Evidenca 1.13. Udhëzim për rekrutimin e stafit akademik;*<br>*Aneksi IV.06. Kriteret e rekrutimit të Stafit Akademik;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi IV.02. Formati i shpalljes së vendit vakant;*<br>*Aneksi IV. 03. Format i vlerësimit të kandidatëve;*<br>*Aneksi IV.04. Modeli i kontratës individuale të punës;*<br>*Aneksi IV.05. Format Urdhër Emërimi;*<br>*Aneksi IV.06. Kriteret e pranimit të personelit akademik me kohë të pjesshme.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Nga dokumentet e dorëzuara dhe tabelat përmbledhëse rezulton se për Programin e studimit Bachelor "Menaxhim Turizmi dhe Mikpritje" është vetëm një personel ndihmës akademik. Stafi ndihmës akademik ndihmon në realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve sipas rregulloreve në fuqi.<br><br>*Tabelat Përmbledhëse*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me | Në UNIKO, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore administron bazën e të dhënave mbi personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. Në dosjen e personelit të punësuBurimeve njerëzore si dhe nga vëzhgimi me zgjedhje rastësore të dosjes së një pedagogu të brendshëm dhe një të jashtëm, rezultoi se dosjet e tyre dokumentacion të plotë (CV, kontratë punësimi, diploma, certifikata kualifikimesh, |

| | |
|---|---|
| legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | certifikata trajnimesh, listë botimesh, listë të konferencave, etj). Nga shqyrtimi i CV-ve personelit akademik rezulton se personeli ka formim akademik të fushave që mbulon.<br>*Evidenca 1.9. Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale;*<br>*Evidenca 1.14. Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit.* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | UNIKO dhe FE kanë nënshkruar shumë marëveshje bashkëpunimi me Institucione shtetërore dhe private, për të mundësuar studentët që të kryejnë detyrimin e praktikave profesionale. Vetë FE ka në listën e dorëzuar 64 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat rreth 32 janë nënshkruar që nga viti 2020 deri në 2024. Kjo tregon për përkushtimin e Institucionit dhe Fakultetit për krijimin e mundësive për studentët që të kryejnë praktikat profesionale në Institucione të specializuara në ofrimin e Turizmit dhe në Mikpritje. Institucion ka në dispozicion staf të kualifikuar për të mbikqyrur dhe ndihmuar studentët gjatë praktikës profesionale.<br>*Aneksi I.39. Marrëveshje bashkëpunimi midis UK dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera;*<br>*Aneksi I.40. Marrëveshje bashkëpunimi të FE-së.* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të | Në Planin mësimor të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje", praktika profesionale është parashikuar të zhvillohet në vitin e tretë dhe të fundit të studimeve. Praktika profesionale ka qenë me 2 kredite dhe 50 orë jashtë auditorit dhe që prej vitit 2022 është bërë me 3 kredite dhe 75 orë jashtë auditorit. Ky ndryshim është në funksion të përmirësimit të cilësisë së përgatitjes së studentëve, jo vetëm nga ana teorike, por edhe praktike.<br>FE ka marrëveshje me disa Institucione, kryesisht në fushën e zhvillimit të Turizmit. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës është i angazhuar në realizimin e praktikave profesionale në përputhje me marrëveshjet institucionale. Ai ndihmon studentët |

| | |
|---|---|
| tyre për praktikën profesionale. | në përmbushjen e detyrave të tyre dhe kryen vlerësimin e përformancës së tyre në përfundimin e praktikës profesionale. Vlerësimi realizohet në bazë të udhëzuesit dhe formateve përkatëse.<br><br>*Aneksi II.01. Plani mësimor i MTM;*<br>*Aneksi I.39. Marrëveshje bashkëpunimi midis UK dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera;*<br>*Aneksi I.40. Marrëveshje bashkëpunimi të FE-së;*<br>*Aneksi I.43. Udhëzues Praktike.* |
| **Konkluzione** | *Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, si dhe pas takimeve dhe vizitave në IAL, GVJ vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur akademik dhe profesional, i cili është në përputhje me fushën e programit, duke siguruar standardet e mësimdhënies për Programin e Studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje". Rekrutimi i stafit akademik, përfshirë ata me kohë të pjesshme, realizohet sipas procedurave të përcaktuara në Ligj, VKM, rregullore dhe udhëzime të brendshme, të cilat janë të hapura dhe transparente.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Gjatë vizitës në mjediset e UNIKO dhe FE, GVJ konstatoi se për studentët ofrohet një infrastrukturë e përshtatshme fizike, didaktike dhe logjistike. Në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik janë auditorët mësimorë: mjediset e mësimdhënies (salla leksione, laboratorë, salla seminare); mjediset e punës (zyra dhe biblioteka); materiale didaktike (smart board, laptop, etj.); materiale logjistike (autoveturë, autobus) të cilat ndihmojnë në realizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.<br>Studentët dhe pedagogët informohen në fillim të çdo semestri për sallat e leksioneve dhe auditorët e tjerë që do të jenë në dispozicion për mësim. Shpërndarja dhe përcaktimi i sallave |

| | |
|---|---|
| | dhe auditorëve për leksione ose seminare bëhet në përputhje me numrin e studentëve dhe specifikat e tjera të lëndëve ose programeve, dhe të gjitha pasqyrohen në orar.<br><br>*Vizita e GVJ-së në Institucion;*<br>*RVB;*<br>*Aneksi III.04. Të dhëna për Infrastrukturën* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Nga vizita në Institucion e GVJ-së dhe dokumentacioni i dorëzuar, konstatohet se përsa i përket auditorëve, laboratorëve, zyrave të pedagogëve të brendshëm etj. shumica janë të pajisur me teknologjinë e duhur për zhvillimin e mësimit cilësor.<br>Programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" zhvillohet në mjediset e FE-së dhe përdor auditorë mësimorë të projektuar si salla audio/vizive, të cilat mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore në mësimdhënie.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion*<br>*RVB*<br>*Shtojca 3.4. Të dhëna për infrastrukturën* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Nga vizita në Institucion dhe dokumentet e dorëzuara, rezulton se UNIKO dhe FE, ku zhvillohet mësimi për Programin Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje", janë të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e mësimit. Në shumicën e auditorëve ka projektorë dhe laptopë ose kompjuterë për prezantimet e ndryshme të stafit akademik dhe studentëve.<br>Ndër laboratorët që janë në funksion direkt dhe ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies janë: "Laboratori Hoteleri-Turizmit" i pajisur me: smart board, kompjutera dhe programe specifike rezervimi me qëllim aftësimin praktik të studentëve; "Laboratori i kompjuterizimit financiar" i pajisur me një set prej 30 kompjutera.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion*<br>*RVB*<br>*Shtojca 3.4. Të dhëna për infrastrukturën* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur | UNIKO dhe FE ka 2 laboratorë të pajisur me mjete teknologjike për prezantime të ndryshme dhe salla të tjera, që gjithashtu mundësojnë përdorimin e teknologjisë në varësi të kërkesave të programit Bachelor në Menaxhim në Turizëm dhe |

| | |
|---|---|
| me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Mikpritje. Një nga programet profesionale specifik për programin e ofruar është edhe HOTS.<br>Gjithashtu, kompjuterat e "Laboratorit të kompjuterizimit financiar" kanë disa programe profesionale, si: Excel për menaxherët, Kontabiliteti Alfa, SQL Server, Oracle, Visual Studio, etj., në mënyrë që studentët të praktikojnë dhe përvetësojnë më mirë mësimet.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion*<br>*RVB*<br>*Shtojca 3.4. Të dhëna për infrastrukturën*<br>*Aneksi IV.14. Program stimulimi HOTS*<br>*Aneksi I.26 Rregullore e programit MTM* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, vizitën e GVJ-së në Institucion dhe takimet e zhvilluara, konstatohet se UNIKO dhe FE, që ofrojnë programin Bachelor "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje", kanë siguruar mjedise të përshtatshme mësimore dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e mësimdhënies dhe praktikave profesionale. Me rëndësi të veçantë janë dy laboratorët specifik për këtë program studimi si dhe programet e veçanta në ndihmë të praktikimit të dijeve nga studentët.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të dorëzuara, diskutimi me Stafin akademik dhe GVB-në, GVJ konstaton se të gjitha silabuset e lëndëve janë të përshtatur me të gjithë elementët (por jo në strukturën e përgjithshme) sipas VKM-së 41/2018 dhe përfshijnë edhe rubrikën e Literaturës. Ajo ndahet në dy pjesë: *Literatura e detyruar*, e cila zakonisht përfshin cikël leksionesh nga pedagogët e lëndëve dhe, në disa raste, libra të botuar nga autorë të tjerë, dhe *Literatura e rekomanduar*, e cila përfshin tituj librash, artikuj në revista, ligje dhe VKM që lidhen me programin e studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje". |

| | |
|---|---|
| | Literatura e vendosur në shumicën e lëndëve të programit të studimit është e vjetër dhe shumë pak tituj mund të jenë literaturë e 5 viteve të fundit sipas VKM 41/2018.<br>***GVJ rekomandon rishikimin e të gjitha silabuseve dhe përshtatjen e tyre sipas VKM 41/2018, si dhe përditësimin e literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar, për ta bërë atë të përfshijë tituj nga 5 vitet e fundit. Studentët kanë mundësi të përdorin Bibliotekën fizike dhe ato online për literaturën bazë ose të rekomanduar. Pjesa më e madhe e literaturës është në gjuhën shqipe.***<br><br>*Vizita dhe takimet e GVJ-së në Institucion;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '22 -'23 Viti I;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti I;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti II;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '22 -'23 Viti II;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti III;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore 2021 -2022 Viti I;* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | UNIKO ndërmerr masa për pasurimin e Bibliotekës nëpërmjet investimeve direkte nga financat e Universitetit ose nëpërmjet dhurimeve nga Institucione e subjekte të ndryshme. Njësia bazë përcjell kërkesat për pasurim të fondit të Bibilotekës me tituj të lidhur me programet e studimit që ofron dhe Rektori nxjerr urdhërin në përgjigje të kërkesave, si dhe në varësi të fondit limit të miratuar në buxhetin vjetor.<br><br>*Vizita dhe takimet e GVJ-së në Institucion;*<br>*Aneksi I.42. Lista e Librave të dhuruara të Fondation Nestle Progastornomia;*<br>*Aneksi III.05. Të dhëna për Bibliotekën;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Studentët dhe pedagogët në UNIKO kanë mundësi të përdorin mjediset e Biblitokës në Rektorat dhe të Bibliotekave në Fakultetet përkatëse.<br>Biblioteka e Fakultetit të Ekonomisë ka 40 vende në dispozicion dhe funksionon në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke ofruar shërbime cilësore, për të mbështetur procesin mësimor, edukativ dhe formimin profesional të studentëve. Studentët kanë të drejtën të frekuentojnë Bibliotekën dhe të përdorin mjediset e saj falas gjatë orarit të shpallur, i cili është i disponueshëm në hyrjen e Bibliotekës dhe në faqen zyrtare online të UNIKO-s. Po ashtu, anëtarët e stafit akademik gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi. |

| | |
|---|---|
| | *Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*RVB;*<br>*Aneksi III.05. Të dhëna për Bibliotekën;* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Literatura në dispozicion të studentëve është e disponueshme si në format fizike, ashtu edhe online. Literatura fizike mund të gjendet në Bibliotekën e FE-së, ndërsa ajo online sigurohet përmes abonimeve të shumta që UNIKO ka realizuar. Institucioni ka gjithsej 44,593 libra dhe mbi 17,350 tituj nga fusha të ndryshme. Biblioteka ofron shërbim falas dhe të barabartë për të gjithë përdoruesit, qofshin ata studentë ose staf akademik.<br>Përveç kësaj, Biblioteka e FE-së është pjesë e rrjetit të Bibliotekave të UNIKO dhe studentët kanë mundësinë të përdorin edhe burimet e tyre. FE disponon një fond prej 6,174 librash dhe 4,112 tituj dhe ofron 40 vende studimi për studentët. ***GVJ gjykon se kapaciteti i Bibliotekës për studentët që duan të shfrytëzojnë mjediset fizike të saj, është relativisht i ulët dhe duhet parë mundësia për zgjerimin e saj ose shtimin e mjediseve të tjera në funksion të Bibliotekës. Gjithshtu, linku për të dhënat e Bibliotekës që është në RVB nuk funksionon dhe në faqen zyrtare online të Institucionit ka pak informacione në lidhje me funksionimin e saj.***<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*RVB;*<br>*Aneksi I.42. Lista e Librave të dhuruara të Fondation Nestle Progastornomia;*<br>*Aneksi III.05. Të dhëna për Bibliotekën;* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Studentët dhe stafi akademik i UNIKO dhe FE-së kanë mundësi të shfrytëzojnë disa Biblioteka online, falë abonimeve që Institucioni ka kryer ose marrëveshjeve për abonime falas në to. UNIKO është i abonuar në 26 baza të dhënash elektronike, ku studentët mund të lexojnë online materiale dhe tekste të plota. Disa nga Bibliotekat online ku është abonuar UNIKO janë: JSTOR (me financim nga AADF); U-Library (financuar nga RASH); Springer (falas); Open Library (falas), si dhe është në proces katagolimi të fondit të Bibliotekës në sistemin COBISS.<br><br>*Aneksi III.05. Të dhëna për Bibliotekën;* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, | Biblioteka është e pajisur me kompjuter dhe programe që mundësojnë studentët të kenë akses në literaturë online në përputhje me programin mësimor. Përdorimi i internetit falas në këtë hapësirë ofron mundësi të favorshme për studime |

| | |
|---|---|
| që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | online, duke mundësuar konsultimin me materiale të ndryshme shkencore dhe mësim në distancë.<br>Studentët dhe stafi akademik kanë mundësinë të përdorin fondin online të bibliotekave U-Library dhe JSTOR në çdo kohë dhe vend. Shfrytëzimi i bibliotekave online rrit mundësitë për aksesimin e literaturës në gjuhë të huaja dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*RVB;*<br>*Aneksi III.05. Të dhëna për Bibliotekën;* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka e FEF është në shërbim të përdoruesve nga dita e hënë deri ditën e premte, nga ora 8.00 deri në orën 16.00. Oraret e saj janë të afishuara në hapësira të dukshme dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*RVB;* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Sipas RVB-së dhe diskutimeve me grupe të ndryshme në Institucion, vihet re se njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi dhe Mikpritje" bashkëpunon në mënyrë periodike me Bibliotekën dhe propozon pasurimin e saj me titujt e fundit dhe evidentimin e titujve të tjerë të rëndësishëm për programin e studimit. ***Megjithatë, në dokumentet mbështetëse të dorëzuara nuk është pasqyruar kjo praktikë dhe ka shumë pak dokumente mbështetëse për procedurën që ndiqet për pasurimin e Bibliotekave me titujt e rinj.***<br>***Në buxhet gjithashtu, nuk është shumë e qartë se sa është fondi për Bibliotekat.***<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*RVB;*<br>*Aneksi III.05. Të dhëna për Bibliotekën;* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, RVB-së dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se UNIKO dhe FE ka vënë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve të programit Bachelor "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" Bibliotekën e Rektoratit dhe të FE-së. Biblioteka ka mjedise të përshtatshme dhe pajisje teknike për shfrytëzimin e literaturës fizike ose online. UNIKO ka disa marrëveshje me Bibliotekat online për tu shfrytëzuar falas nga studentët dhe pedagogët..*<br>*GVJ gjithashtu vëren se syllabuset e lëndëve nuk janë të përshtatur plotësisht sipas VKM 41/2018 dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar nuk është e përditësuar për 5 vitet e fundit. Po ashtu, GVJ rekomandon përfshirjen e një fondi të qartë në buxhet për pasurimin e Bibliotekës, pasi nuk është i qartë në dokumentet mbështetëse të dorëzuara.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Nëpërmejt marrëveshjes së nënshkruar me RASH, UNIKO ka filluar implementimin dhe mirëmban sistemin PITAGORA, me anë të të cilit menaxhohet infromacioni i plotë për studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi e deri në diplomim. Me anë të Rregulloreve të veçanta, UNIKO siguron mbrojtjen e informacionit strategjik dhe të të dhënave personale të çdo studenti apo stafi akademik të regjistruar në të.<br>Sekretaria elektronike PITAGORA, është në funksion dhe ka lehtësuar administrimin e të dhënave të plota për studentët dhe aktivitetet e tyre, duke përfshirë regjistrimin në programet e studimit, transferimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, listat e notave, informacionin në diplomim dhe gjurmimin e të dhënave pas përfundimit të studimeve.<br>Studentët dhe pedagogët kanë në dispozicion Manualin e sistemit elektronik, që u lehtëson përdorimin e tij në të gjithë elementët.<br><br>*Evidenca 1.6. Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA;*<br>*Evidenca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA;* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 1.9. Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Informacioni i përgjithshëm, dokumentacioni i dorëzuar dhe aktiviteti i personelit akademik, ndihmës akademik dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Protokolli dhe Arkivi. Dokumentet e krijuara nga pedagogët lidhur me vlerësimin e studentëve (vlerësimi i vazhduar dhe provimi përfundimtar) menaxhohen përmes sistemit PITAGORA.<br>Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen dhe ngarkimin e disa dokumenteve në sistemin PITAGORA si p.sh: formulari i ngarkesës semestrale/vjetore dhe regjistri i pedagogut. Monitorimi i dokumenteve bëhet nga drejtuesit e njësive dhe grupi i monitorimit në nivel institucional.<br><br>*Evidenca 1.6. Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik PITAGORA;*<br>*Evidenca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA.*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE-së.* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | UNIKO ka në përdorim sistemin PITAGORA ku menaxhon shumicën e informacioneve. Në këtë sistem krijojnë llogaritë e tyre stafi akademik dhe studentët dhe e përdorin atë nëpërmjet një emri përdoruesi unik dhe një fjalëkalimi. Stafi akademik dhe studentët mund të informohen dhe të mësojnë përdorimin e sistemit PITAGORA nëpërmjet Manualit të publikuar në faqen online të UNIKO.<br><br>Përveç sistemit PITAGORA përdoret edhe sistemi ESSE3.<br>*Vizitë e GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe sekretari.*<br>*Evidenca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/05/Manual-per-studente-per-sistemin-Pitagora-fund.pdf* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | UNIKO ka mundësuar përdorimin e disa platformave, sistemeve dhe moduleve online, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e ndërveprimit dhe shkëmbimit aktiv të informacionit mes stafit akademik, studentëve dhe stafit administrativ, etj. Sipas RVB-së, takimeve të GVJ-së në Institucion, si dhe kontrollit të faqes online të Universitetit të Korçës, është vënë re se stafit akademik dhe studentëve u është ofruar libraria digjitale U-Library, e cila është lehtësisht e aksesueshme nga të dy palët, studentët dhe pedagogët. Gjithashtu, janë në dispozicion platformat digjitale për menaxhimin e mësimit, si Google Classroom, Moodle, etj., së |

| | |
|---|---|
| | bashku me manualet përkatëse dhe Paketa Office 365 for education.<br><br>*Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore; takim me stafin akademik;*<br>*Evidenca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA;*<br>*https://unkorce.edu.al/lms-2*<br>https://www.proquest.com/?accountid=143248<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/05/Manual-per-studente-per-sistemin-Pitagora-fund.pdf;*<br>*https://www.docdroid.net/XXA7fWr/manual-edumeet-1-pdf* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Sistemi i menaxhimit Pitagora, si dhe sistemet e tjera online, të përdorura në UNIKO, mundësojnë monitorimin e aktiviteteve akademike dhe administrative nga organet drejtuese.<br>Një nga përfitimet kryesore të përdorimit të këtyre platformave dhe sistemeve online është mundësia për të krijuar automatikisht raporte për të gjitha veprimtaritë që pasqyrohen në to. Avantazh tjetër është edhe se mund të përdoren kudo dhe kurdo të gjitha informacionet e regjistruara në sistem nga Fakulteti, Departamenti dhe stafi akademik (si programet lëndore, vlerësimi i vazhduar, vlerësimi përfundimtar, etj.). Të dhënat personale dhe institucionale që përpunohen në këto platforma mbrohen në përputhje me politikën e privatësisë të UNIKO.<br><br>*Evidenca 1.9. Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.*<br>*Evidenca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA;*<br>*https://unkorce.edu.al/lms-2*<br>https://www.proquest.com/?accountid=143248<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/05/Manual-per-studente-per-sistemin-Pitagora-fund.pdf;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/05/Manual-per-studente-per-sistemin-Pitagora-fund.pdf;* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | GVJ kontrolloi faqen zyrtare të UNIKO dhe nënfaqen për Fakultetin e Ekonomisë dhe konstatoi publikimin e aktiviteteve të realizuara nga institucioni në kuadër të përmbushjes të programeve të studimit që ofron si dhe të programit Bachelor "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje".<br>Në nënfaqen e Fakultetit të Ekonomisë ka informacione në lidhje me Departamentet, programet e ofruara nga secili Departament, veprimtaritë e ndryshme, botimet, njoftime etj.<br>GVJ sugjeron që çdo Fakultet është mirë të ketë një faqe zyrtare online, ku të ketë të pasqyruar më shumë aktivitete |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dhe informacione në lidhje me funksionimin e tij, departamentet, programet e ofruara etj.<br><br>*https://unkorce.edu.al/*<br>*https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-ekonomise-3/*<br>*https://unkorce.edu.al/departamenti-i-marketing-turizem/#* | | | |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si dhe në takimet dhe vizitat e realizuara në IAL, GVJ arrin në përfundimin se institucioni ka në dispozicion sistemin PITAGORA dhe sisteme e platforma të tjera të brendshme që përdoren për menaxhimin institucional. Ato ndihmojnë për administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ të programit Bachelor "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje".* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | UNIKO, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe Statutin e tij, operon sipas parimit të autonomisë financiare. Menaxhimi i financave bëhet nga strukturat përkatëse të ngritura në këtë Institucion të Arsimit të Lartë (IAL), duke u bazuar në ligjet, aktet nënligjore, dhe rregulloret e Institucionit.<br>Sipas Statutit të UNIKO, projekt-buxheti në nivel Institucioni për vitin e ardhshëm përgatitet në fund të çdo viti akademik, pas grumbullimit të propozimeve nga çdo njësi bazë dhe kryesore. Ai hartohet nga Administratori i UNIKO, sipas kërkesës së Senatit Akademik, i cili më pas e shqyrton dhe vendos nëse do të miratohet apo jo. Rektorati është përgjegjës për dërgimin e projekt-buxhetit në Senatin Akademik për miratim. Pas kësaj, me kërkesën e Senatit Akademik, projekt-buxheti miratohet edhe nga Bordi i Administrimit.<br><br>*Evidenca 1.1. Statuti i UK;*<br>*Aneksi IV.11. Fondet e UK Grand i Buxhetit;*<br>*Aneksi IV.12. Rregullore financiare e shpërndarjse së të ardhurave të UK.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | UNIKO gjeneron të ardhura nga disa burime, të tilla si: buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për regjistrime dhe studime, donacione nga burime të ligjshme financimi, të ardhurat nga shërbime të tjera si dhe të ardhurat nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, etj. Burimet nga ku gjenerohen të ardhurat e UNIKO specifikohen qartë edhe në Statutin e Universitetit.<br><br>Në planin financiar të UNIKO dhe në rregulloren financiare parashikohet shpërndarja e të ardhurave sipas disa zërave si p.sh.: financiami i burimeve njerëzore (paga, shpërblime), shpenzime operative për mirëmbajtjen e mjediseve, shpenzime për pasurimin e literaturës në funksion të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje". Vetë Fakulteti i Ekonomisë ka siguruar edhe grante të huaja për financimin e programit të studimit Bachelor MTM, siç është fondi për Bibliotekën elektronike e Institutit të Mikpritjes (Institute of Hospitality, IoH e-library), e sponsorizuar nga fondacioni "La Fondation pour la Formation Hôtelière" në tetor 2014, dhe ka hyrë në skemën "Education Membership Scheme" (EMS).<br><br>*Evidenca 1.1. Statuti i UK;*<br>*Aneksi IV.11. Fondet e UK Grand i Buxhetit;*<br>*Aneksi IV.12. Rregullore financiare e shpërndarjse së të ardhurave të UK.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | UNIKO, si të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë, përveçse realizon Vlerësim të brendshëm në nivele të ndryshme (Universiteti, Fakulteti etj.) i nënshtrohet edhe auditimit nga: MAS dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.<br>UNIKO dorëzon çdo vit pranë MAS dhe Degës së Thesarit, Korçë, pasqyrat financiare vjetore dhe të gjitha dokumentet të tilla si: Raportet e Auditit dhe Buxhetet apo pasqyrat financiare bëhen publike nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Korçës.<br>***Megjithatë, nga kërkimi që GVJ bëri në faqen zyrtare online të UNIKO, nuk gjeti dokumentet e sipërpërmendura dhe konstaton se një praktikë e tillë (e pasqyrimit dhe publikimit të raporteve) nuk është shumë e rregullt.***<br>***Për këtë aspekt, GVJ sugjeron që t'i kushtohet vëmendja e duhur publikimit në kohë të dokumenteve dhe raporteve të auditimeve të ndryshme, për të rritur transparencën e Institucionit.***<br><br>*Aneksi VI.02. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të FE;* |

| | |
|---|---|
| | *https://unkorce.edu.al/archive/programi_transparences/programi_i_transparences.php#*<br>*Evidenca 1.15. Raport i kontrollit të MASR për kapacitetet pritëse të UNIKO 2023-2024.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Raporti i veprimtarisë financiare diskutohet në organet kolegjiale të UNIKO, si Rektori, Bordi i Administratës dhe Senati Akademik. Ky raport është gjithashtu transparent dhe ofron informacion për të gjithë personelin dhe studentët që janë të interesuar.<br><br>*Evidenca 1.1. Statuti i UK;*<br>*Aneksi IV.11. Fondet e UK, Grandi i Buxhetit të Shtetit;* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Qëndrueshmëria financiare në UNIKO sigurohet nga Bordi i Administrimit, në përputhje me dispozitat e Statutit të Institucionit. Nga dokumentet e dorëzuara dhe takimet e GVJ-së gjatë vizitës në Institucion, u vërejt një nivel relativisht i mirë i qëndrueshmërisë financiare për UNIKO, ku disa nga treguesit e marrë në konsideratë janë: granti i buxhetit të shtetit akorduar nga MAS, të ardhurat e krijuara prej tarifës së shkollimit të studentëve, të ardhura të krijuara nga ofrimi i shërbimeve palëve të treta etj.<br><br>*Evidenca 1.1. Statuti i UK;*<br>*Aneksi IV.11. Fondet e UK, Grandi i Buxhetit të Shtetit;*<br>*Aneksi IV.12. Rregullore financiare e shpërndarjes së të ardhurave të UK.* |
| **Konkluzione** | *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, RVB-së dhe nga vizitat dhe takimet në Institucion, GVJ konstatoi se UNIKO ka në funksion sistemin e brendshëm të menaxhimit të Institucionit. Ky sistem është në dispozicion për administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit financiar dhe administrativ të programit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje". Gjatë kërkimit në faqen zyrtare online të UNIKO, GVJ vuri re se nuk kishte publikime periodike të raporteve financiare ose të auditimit financiar dhe i sugjeron Institucionit të përditësojë informacionin dhe të publikojë raportet për të qenë në dispozicion të stafit akademik, studentëve dhe palëve të tjera të interesuara. Gjithashtu, RVB, për shumë nga kriteret është shumë i përgjithshëm, shkurt dhe pa detaje të lidhura direkt me programin e studimit dhe me shumë pak referenca mbështetëse.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1<br>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje", i ofruar nga FE në UNIKO, është në përputhje me Ligjet, VKM-të dhe Udhëzimet në fuqi për IAL-të dhe programet që ato ofrojnë. Politikat dhe procedurat e ciklit të plotë akademik të studentëve, që nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre, janë të përcaktuara në Statutin e UNIKO. Institucioni, në përfundim të studimeve i pajis studentët me Diplomën dhe Suplementin, formati i të cilave, gjithashtu është i përcaktuar dhe i miratuar.<br>Këto procedura, me të gjithë detajet e tjera dhe përshtatjet sipas programit të studimit Bachelor "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" janë të pasqyruara edhe në nene të veçanta të Rregullores së FE-së dhe Rregullores së Programit të studimit MTM.<br><br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*Aneksi I.26. Rregullore e Programit të studimit MTM;*<br>*Aneksi I.29. Kurrikula e Programit të Studimit MTM.* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" është organizuar dhe funksionon në përputhje me Rregulloren për organizimin dhe veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore të Programit të studimit MTM, FE-së dhe UNIKO, si dhe në përmbushje të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Ky program ka të përcaktuara dhe zbaton rregulla të qarta dhe të barabarta për çdo student që e ndjek atë, duke garantuar të drejta të njëjta nga regjistrimi deri në përfundimin e |

| | |
|---|---|
| | studimeve.<br>Rregullorja e UNIKO specifikon funksionimin e programeve të studimit dhe kohëzgjatjen e tyre, përfshirë procedurat dhe kriteret e pranimit në ciklin e parë të studimeve, programet e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, si dhe detajet e kohëzgjatjes dhe mundësive për transferim. Po ashtu, Rregullorja e FE është hartuar specifikisht për programet e studimit të ofruara nga ky fakultet dhe më në detaje këto shpjegohen në Rregulloren e Programit të studimit MTM.<br>Përcaktimi i qartë dhe shpallja e kritereve sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët dhe studentët, duke ndërlidhur aktivitetet akademike dhe programet e studimit mbi parime barazie dhe drejtësie. Procesi që ndjek një student nga regjistrimi deri në diplomim është i organizuar sipas formave të përcaktuara për mësimdhënien, vlerësimin, detyrimet dhe të drejtat e studentëve. Sipas Statutit të UNIKO dhe Rregullores së FE, pranimi i studentëve në ciklin e parë të studimeve bëhet sipas udhëzimeve dhe kuotave të përcaktuara nga aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe MASR për vitin akademik përkatës. Ky program është i hapur për shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë jashtë kufijve dhe shtetas të huaj që plotësojnë kriteret, pa dallim gjinie, moshe, origjine apo etnie.<br>Nga vizita në Institucion dhe takimet me studentët, GVJ konfirmon se procedurat dhe kriteret zbatohen në UNIKO dhe FE. Sipas Rregullores së FE, kandidatët që shpallen fitues fitojnë statusin e studentit pas regjistrimit në sekretarinë mësimore të Fakultetit dhe krijohet një llogari edhe në sistemin PITAGORA, duke siguruar akses të barabartë, marrjen e informacionit në kohë reale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave.<br>Zyra e informimit dhe orientimit për studentët në FE ofron informacion të rregullt dhe të paanshëm për regjistrimin dhe përdorimin e sistemit PITAGORA, për ecurinë akademike dhe procedurat e diplomimit, deri në marrjen e diplomës.<br><br>*Vizita dhe takimet e GVJ-së në Institucion;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*Aneksi I.26. Rregullore e Programit të studimit MTM;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik | Departamenti i Marketing-Turizëm, ku ofrohet programi studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje", harton dhe propozon kriteret e veçanta të pranimit të |

| | |
|---|---|
| kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | studentëve, për çdo vit akademik. Këto kritere përcillen për miratim në Senatin e Universitetit. Disa nga kriteret e veçanta, për të cilat është përgjegjës Departamenti, që t'i propozojë, lidhen me profilin e studimit në shkollën e mesme të lartë, cilësinë e vlerësimeve të maturanitit, nevojat e tregut të punës, kualifikime paraprake (nëse janë të nevojshme) etj.<br>Procedura e shpalljes së kritereve, konkurimit dhe pranimit të studentëve, kryhet duke u mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015; Statutin e UNIKO dhe Rregulloret sipas niveleve.<br><br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*Aneksi I.26. Rregullore e Programit të studimit MTM;* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Institucioni ka përgatitur një Udhërrëfyes për të gjithë studentët, me fokus të veçantë për ata në vitin e parë. Po ashtu, në faqen zyrtare online të UNIKO, studentët mund të shkarkojnë Udhërrëfyesin, dokumentin për Kriteret dhe Tarifat, si dhe dokumente orientuese për sallat ku zhvillohen leksionet ose seminaret etj.<br>Udhërrëfyesi është një dokument i detajuar që u ofron studentëve informacion të plotë për çdo aspekt të jetës së tyre studentore në UNIKO.<br>Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, kriteret miratohen nga Senati Akademik dhe shpallen me vendim të Rektorit.<br>Forma të tjera që Fakulteti përdor për të shpallur kriteret dhe informacione të tjera janë: fletëpalosjet, stendat informuese në mjediset e FEF, takimet e drejtpërdrejta me studentët, shërbimi i ofruar nga zyra e informimit për çdo student, si dhe informacione të shpërndara nga drejtuesit e njësive bazë, pedagogët dhe koordinatorët e programeve.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Aneksi 1.23. Ligje, VKM dhe Udhëzime*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*Aneksi I.26. Rregullore e Programit të studimit MTM;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/udherefyesi2022.pdf* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, | Përpara fillimit të çdo viti akademik, UK, FE dhe Departamenti i Marketing-Turizmit organizojnë fushata |

| | |
|---|---|
| institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | promovimi për të informuar kandidatët për studentë në lidhje me programet e studimit që ky Fakultet dhe Departament. Fushata zhvillohet sipas kalendarit të publikuar në kuadër të aktivitetit "Ditët e informimit të maturantëve". Promovimi i UNIKO-s, FE-së dhe programeve të studimit që ato ofrojnë realizohet nëpërmjet vizitave informuese në shkollat e mesme të Qarkut të Korçës dhe me anë të aktiviteteve në ditët e hapura në FE. Gjatë këtij aktiviteti, maturantët kanë mundësinë të vizitojnë mjediset e UK dhe FE, si dhe të marrin informacion për programin e studimit, kriteret e pranimit, strukturën, organizimin, kohëzgjatjen, veprimtaritë formuese, aftësitë dhe kualifikimet, mundësitë e punësimit dhe karrierës.<br>Procesi dhe aktivitetet e informimit të maturantëve dhe promovimit të Institucionit realizohet nga QKA në bashkëpunim me departamentin përkatës. Gjatë fushatës promovuese shpërndahen fletëpalosje informuese, me qëllim që maturantët të kenë informacion më të detajuar për programin e studimit. Kandidatët për studentë dhe të gjithë të interesuarit mund të informohen për kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit, përmes publikimit të informacionit në faqen zyrtare të UK, nënfaqen e FE dhe në kategorinë "Studentët".<br><br>*Aneksi I.28. Analiza e Veprimtarisë së QKA;*<br>*https://unkorce.edu.al/studentet-qendra-e-karrieres-dhe-alumni/* |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Në UNIKO dhe FE, kriteret e pranimit të studentëve shpallen me vendim të Rektoratit, pas miratimit nga Senati Akademik, në përputhje me Ligjin 80/2015. Në Rregulloren e UNIKO përcaktohet se për pranimet në Universitet, për cddo programi studimi, ndiqet parimi i barazisë dhe se të gjithë ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara kanë të drejtë të regjistrohen, pa diskriminim në bazë të gjinisë, etnisë, origjinës apo shtetësisë. Programi i studimit mund të ndiqet nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë jashtë kufijve shtetërorë, si dhe nga çdo shtetas i huaj, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MAS.<br>Në dokumentet që janë publikuar në faqen e internetit të UNIKO, janë të deklaruara kuota më vete për kandidatët me aftësi të veçanta ose për shtresat e margjinalizuara, të cilat parashikohen edhe për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje".<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;* |

| | |
|---|---|
| | *Aneksi 1.23. Ligje, VKM dhe Udhëzime*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/UNIKO-Tabela-kuota-2024-2025-16.10.2024.pdf* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UNIKO dhe FE, kanë parashikuar që studimet në programet e studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje", mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnikë jashtë kufijve shtetërorë si dhe nga çdo shtetas i huaj.<br>Kriteret dhe kuotat për secilën kategori hartohen dhe publikohen përpara çdo viti në përputhje me Statutin e UNIKO, Rregullorja e UNIKO dhe Rregulloren e FE-së.<br><br>*RVB;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/UNIKO-Tabela-kuota-2024-2025-16.10.2024.pdf* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | GVJ nga dokumentacioni bashkëshoqërues konstaton se UNIKO zbaton aktet ligjore dhe VKM-të në fuqi, që lidhen me kategoritë e individëve që përjashtohen nga tarifat e shkollimit dhe kushtet e përfitimit të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë.<br>Sipas dokumentit online në linkun: *https://unkorce.edu.al/ëp-content/uploads/2024/12/UNIKO-Tabela-kuota-2024-2025-16.10.2024.pdf,* për Programin Bachelor në Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje janë parashikuar: 1 kuotë për ata që kanë statusin e jetimit; 1 kuotë për persona me aftësi të kufizuar; 1 kuotë për persona nga komuniteti Romë dhe balkano egjiptian. Këto kategori përjashtohen nga tarifa e studimit.<br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/UNIKO-Tabela-kuota-2024-2025-16.10.2024.pdf* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe vizitat e takimet me stafin akademik, jo akademik, studentët etj., GVJ arrin në përfundimin se UNIKO kujdeset dhe vë në dispozicion të studentëve të programit Bachelor "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" informacion të plotë e të hollësishëm mbi* |

| | |
|---|---|
| | *përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve të tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Institucioni ka përcaktuar në Rregulloren e UNIKO, të FE-së dhe të Programit të studimit MTM, mënyrat e informimit të studentëve për kriteret dhe procedurat e avancimit të tyre akademik. Gjatë vizitës në Institucion dhe takimeve me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të mirëinformuar rreth kërkesave dhe procedurave të përparimit akademik, kalimit nga një vit në tjetrin, si dhe numrit të krediteve të nevojshme për çdo vit të studimit.<br>Informacioni ofrohet në forma dhe nga burime të ndryshme. Përveç Rregulloreve, informacioni shpërndahet gjithashtu përmes posterave dhe njoftimeve të vendosura në të gjitha pikat informuese si: stenda, monitorë, etj., si dhe nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Informimit dhe Orientimit të Studentëve.<br>Gjithashtu, informacioni është i disponueshëm në format elektronik në faqen zyrtare tw internetit të UNIKOs.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/09*<br>*https://unkorce.edu.al/studentet-pyesin/* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Në Rregulloren e UNIKO, të Fakultetit të Ekonomisë dhe të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" janë përcaktuar kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, të cilat u bëhen të ditura studentëve në forma të ndryshme. Po ashtu, në këto Rregullore janë parashikuar edhe kriteret dhe rregullat për transferimin, njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe periudhave të studimeve.<br>Nga vizita e GVJ-së në Institucion dhe takimet me stafin akademik, administrativ dhe studentët, u vërejt se studentëve u |

| | |
|---|---|
| | shpërndahet informacion i bollshëm dhe i hollësishëm në forma të ndryshme: virtualisht, përmes faqes zyrtare të internetit të UNIKO, dhe fizikisht përmes stendave informuese, broshurave, fletepalosje etj. Në rast të ndonjë vështirësie, studentët mund të kërkojnë ndihmë dhe orientim nga sekretaria mësimore e FE-së dhe drejtuesi i njësisë përkatëse. Po ashtu, ata informohen mbi procedurat për njohjen e kualifikimeve ose studimeve të pjesshme që mund të kenë kryer në institucione të tjera të Arsimit të Lartë, programe të ndryshme studimi ose studime të realizuara jashtë vendit.<br>Informacione të plota në lidhje me këto aspekte të studimit gjenden edhe në Dosjen e Programit të Studimit. Transferimet mund të realizohen nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtit cikël dhe lloj, i ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose private të licencuara dhe të akredituara, vendase ose të huaja, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta. Studentët që aplikojnë për transferim njoftohen për vendimin e Komisionit të Njohjes dhe Ekuivalentimit përmes sekretarisë mësimore, zyrës së informimit dhe orientimit të studentëve, drejtuesit të njësisë përkatëse, si dhe shpalljes së rezultateve në stendat informuese të FE-së. Pas regjistrimit, aplikanti fitues merr kartelën personale të përgatitur nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit të Studimeve, ku tregohet numri i krediteve të fituara, viti i studimeve, modulet e përfunduar sipas planit mësimor, ato që duhet të ndjekë dhe modulet e ndjekura por të pa përfunduar (për çdo vit akademik).<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion, takimet me studentët, stafin akademik dhe administrativ;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, vizitat dhe takimet e GVJ-së në Institucion, si dhe kërkimet në faqen zyrtare të internetit të UNIKO, vihet re se Institucioni ka marrë të gjitha masat për të informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre për lëndët dhe programet e studimit.<br>Këto kritere dhe procedura bëhen të njohura për studentët përmes Rregulloreve të FE-së dhe UNIKO-s, Rregullores së Programit të Studimit MTM, dokumenteve të tjera si Udhërrëfyesi dhe Informimi i Përgjithshëm për studentët e viteve të para, silabuseve të lëndëve, dhe komunikimeve nga personeli akademik dhe jo akademik në fillim të çdo semestri, etj. |

| | |
|---|---|
| | Në këto Rregullore janë përcaktuar format e kontrollit të dijeve dhe qëllimi i tij. Pedagogët, në fillim të çdo lënde, duhet të njoftojnë studentët për format e kontrollit dhe vlerësimin e dijeve. Sipas Rregulloreve të UNIKO, kontrolli i dijeve mund të realizohet përmes testimeve me gojë apo me shkrim, detyrave të kursit, eseve, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomës. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentëve gjatë vitit akademik.<br>Studentët njoftohen për format e vlerësimit dhe rezultatet e tyre edhe përmes sistemit online PITAGORA, ku mund të komunikojnë drejtpërdrejt me pedagogët e lëndëve, etj. Ata gjithashtu kanë të drejtë të ankimojnë vlerësimet e marra dhe të kërkojnë ngritjen e një komisioni të ri për vlerësim, nëse ankesa e tyre konfirmohet.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion, takimet me studentët, stafin akademik dhe administrativ;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '22 -'23 Viti I;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti I;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti II;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '22 -'23 Viti II;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti III;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore 2021 -2022 Viti I;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/udherefyesi2022.pdf;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/12/INFORMIM-I-PERGJITHSHEM-PER-VITET-E-PARA.pdf* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Kriteret dhe procedurat që studentët duhet të ndjekin gjatë gjithë procesit të diplomimit, nga përzgjedhja e temës deri në mbrojtjen e diplomës, përcaktohen në Rregulloren e FE dhe në Rregulloren e programit të studimit MTM. Në fillim të vitit të tretë, çdo titullar lënde harton një grup temash që i paraqet Përgjegjësit të Departamentit për miratim. Studentët zgjedhin temën në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës.<br>Përgjegjësi i Departamentit, duke u bazuar në preferencat e studentëve, përcakton listën e studentëve, temat dhe pedagogët udhëheqës. Kjo shpallet nga sekretaria mësimore dhe afishohet në stendat e FE. Kriteret dhe procedurat për punimin e diplomës miratohen nga Departamenti dhe prezantohen çdo vit në Udhëzuesin e diplomës, i cili është në dispozicion të |

| | |
|---|---|
| | studentëve. Informacioni i përditësuar shfaqet në stendat dhe monitorët e FE-së, si dhe në faqen ëeb të UK.<br><br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*Aneksi II.16. Lista e Temave të Diplomës për programin e studimit MTM;*<br>*Aneksi II.04. Udhëzues për punimin e Diplomës.* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) e Universitetit të Korçës (UNIKO) angazhohet në organizimin e aktiviteteve për informimin e maturantëve dhe studentëve të ardhshëm të këtij institucioni. QKA përgatit dhe publikon kalendarin e aktiviteteve në faqen zyrtare të UNIKO-s. Po ashtu, ajo informon studentët e ardhshëm përmes shpërndarjes së materialeve të ndryshme informuese, si fletëpalosje, postera, dhe publikimeve periodike në faqen e internetit, rrjetet sociale, si dhe televizionet lokale.<br>Në kalendarin e aktiviteteve të QKA-së përfshihet edhe grafiku i takimeve informative dhe të hapura që organizohen në shkollat e mesme të Qarkut të Korçës dhe më gjerë, ku marrin pjesë pedagogë ose anëtarë të stafit akademik.<br><br>*Aneksi I.28. Analiza e Veprimtarisë së QKA;*<br>*https://unkorce.edu.al/studentet-qendra-e-karrieres-dhe-alumni/* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe vizitat e takimet me stafin akademik, jo akademik, studentët etj., GVJ konkludon se UNIKO vë në dispozicion të studentëve të programit Bachelor në Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve të tyre. Gjithashtu, studentët marrin udhëzimet e duhura edhe për punimin e diplomës, formatin e saj, mënyrën e paraqitjes së referencave etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | UNIKO, përmes Fakulteteve dhe Departamenteve për çdo program, përdor metoda të ndryshme për t'i informuar studentët mbi strukturën dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Sipas Rregullores për Vlerësimin e Buxhetit dhe pas takimeve me studentët dhe stafin akademik, Departamenti i Marketing-Turizmit që ofron programin e studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje", organizon takime informuese për këtë program, ku prezantohen elementët kryesorë të tij, si: plani mësimor, kohëzgjatja e programit, struktura e Institucionit, etj.<br>Studentët mund të marrin informacion të detajuar edhe përmes faqes zyrtare online të UNIKO, broshurave informuese, afisheve në këndet e njoftimeve dhe kanaleve të tjera mediatike.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion, takimet me studentët, stafin akademik dhe administrativ;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*https://unkorce.edu.al/archive/PREZANTIMI;*<br>*https://unkorce.edu.al/studentet-informacioni-i-pergjithshem/;* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Institucioni përdor disa mënyra dhe mediume për t'i informuar studentët në çdo kohë lidhur me rregulloret e programeve të studimit, planet mësimore, lëndët/module, mënyrat e vlerësimit, etj. Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se plani mësimor i programit të studimit, duke përfshirë kreditet, ngarkesën mësimore dhe format e vlerësimit për çdo lëndë, ishte i ekspozuar në këndin e informacionit për studentët e programit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje". Të gjitha këto informacione janë gjithashtu të disponueshme, përveçse në format të printuar, edhe në faqen zyrtare të internetit të UNIKO. Silabusi dhe udhëzimet për detyrat e kursit shpërndahen, përveçse në formë të printuar, edhe përmes platformave digjitale dhe rrjeteve sociale. Po ashtu, sistemi PITAGORA mundëson shpërndarjen e informacionit në kohë reale dhe komunikimin e drejtpërdrejtë mes studentëve dhe pedagogëve.<br>Institucioni organizon gjithashtu pyetësorë për studentët, të cilët japin mendime rreth cilësisë së mësimdhënies, infrastrukturës fizike dhe virtuale, si dhe aspekteve të tjera të programit të studimit. Kjo është një praktikë e mirë për të mbledhur informacion të drejtpërdrejtë nga studentët dhe për të ndërmarrë masa për përmirësim në të ardhmen. Në dokumentet e dorëzuara dhe në faqen zyrtare online të UNIKO nuk ekzistojnë pyetësorë të veçantë për programin Bachelor në |

| | |
|---|---|
| | "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" në përfundim të çdo semestri ose viti akademik. Sugjerohet që kjo praktikë të fillojë të aplikohet në të ardhmen.<br><br>*Aneksi I.29. Kurrikula e Programit të studimit MTM;*<br>*1.23. Kurrikula e programit të studimit;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '22 -'23 Viti I;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti I;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti II;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '22 -'23 Viti II;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore '23 -'24 Viti III;*<br>*Aneksi I.30. Programe lëndore 2021 -2022 Viti I;*<br>*https://unkorce.edu.al/archive/PREZANTIMI;*<br>*https://unkorce.edu.al/studentet-informacioni-i-pergjithshem/;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Në Rregulloret e FE-së dhe UNIKO-s përcaktohet detyrimi i Institucionit për të informuar studentët mbi mundësitë e punësimit dhe për orientimin drejt tregut të punës. Departamenti i Marketing-Turizmit në aktivitetet e tij, si dhe në bashkëpunim edhe me QKA kanë në vëmendje informimin e studentëve për këto çështje, sidomos në fillim të çdo viti akademik dhe në javën e orientimit.<br>Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nga QKA, nëpërmjet faqes zyrtare online të Universitetit, mbi mundësitë për punësim dhe thirrje për vende vakante në Institucione të tjera ose kompani private e shtetërore. Departamenti ka vendosur në shërbim të studentëve edhe dokumentin me Listën e Moduleve orientuese për Tregun e Punës. Përveç kësaj, do duhej të ishtë bërë edhe një analizë e punësimit të studentëve që kanë mbaruar studimet në këtë program.<br>QKA ndihmon studentët edhe me trajnime e ëorkshope në lidhje me përgatitjen e CV-së sipas kërkesave të punëdhënësve, përgatitjen për intervistën e punës, modele të suksesshme etj.<br>Në shërbim të studentëve ekzistues është krijuar edhe rrjeti Alumni i UNIKO, me të cilët organizohen takime orientuese për punësimet e ardhshme të studentëve, trajnime, krijimin e lidhjeve të qëndrueshme etj.<br>Gjithashtu, UNIKO kujdeset që të marri pjesë çdo vit në Panairin e punës, i cili organizohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Panairi është një mundësi shumë e mirë për studentët për të krijuar lidhje të drejtpërdrejta me bizneset apo Institucionet ku mund të punësohen në të ardhmen. |

| | |
|---|---|
| | *Vizita e GVJ në Institucion dhe takimet e ndryshme;*<br>*RVB;*<br>*https://unkorce.edu.al/njoftime-punesimi/*<br>*Aneksi I.31. Module orientuese për Tregun e punës.* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Gjatë vizitës në UNIKO dhe takimeve të realizuara, GVJ u njoh me sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Departamenti cakton Koordinator për programin e studimit, i cili kujdeset që për të pasur komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe i informon ata në lidhje me njoftimet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, aktivitete të ndryshme etj.<br>Një mënyrë tjetër e komunikimit të njoftimeve, është nëpërmjet publikimit të tyre në këndin e caktuar, si dhe me anë të formave digjitale, postës elektronike të studentëve, sistemeve digjitale, Udhërrëfyesit për studentët, sekretarisë mësimore, etj.<br>Sa i përket aktivizimit të llogarive në sistemin PITAGORA dhe platformat e tjera që përdoren nga UNIKO dhe FE, studentët informohen dhe mbështeten nga specialistët IT për të rritur numrin e përdoruesve dhe përfituesve nga shërbimet online që ofron Institucioni.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*https://unkorce.edu.al/*<br>*Aneksi II.09. Vendim i emërimit të Koordinatorit të Programit të Studimit.* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Gjatë vizitës në Institucion dhe takimit me studentët dhe sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se studentët mund të aksesojnë informacionet në lidhje me programin e studimit nga të gjitha mjetet elektronike që kanë në përdorim: laptop; tableta, telefona smart, desktop etj., në kohë reale dhe kudo që të ndodhen, me anë të përdorimit të sistemit PITAGORA. Sistemi PITAGORA mundëson administrimin e gjithë informacionit për studentët dhe aktivitetet e tyre. Në këtë sistem administrohet: regjistrimi i studentëve, transferimi i tyre, faturimet, pagesat e ndryshme, lista e notave etj.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Evidenca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA* |
| **Konkluzione** | *Pas vizitës në Institucion, takimet e zhvilluara, shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara dhe RVB-së, GVJ konstaton se të gjitha kriteret për ofrimin e informacionit të plotë dhe të detajuar për studentët në lidhje me objektivat formuese,* |

| | |
|---|---|
| | *strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit, janë plotësuar nga ana e UNIKO dhe FE për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Gjatë vizitës në institucion, GVJ shqyrtoi dokumentacionin fizik që lidhej me statistikat vjetore për numrin e studentëve që kanë aplikuar, kanë vazhduar studimet dhe janë diplomuar në programin e studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje". Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar në vite të ndryshme akademike, të arkivuara në Zyrën e Informacionit dhe Statistikës. Numri i studentëve të regjistruar në vit të parë rezultoi si më poshtë:<br>*viti akademik 2021 – 2022 = 9 studentë;*<br>*viti akademik 2022 – 2023 = 19 studentë;*<br>*viti akademik 2023 – 2024 = 25 studentë;*<br>Nga kontrolli i regjistrave në Sekretarinë Mësmore, GVJ konstaton se të dhënat janë të sakta dhe të ruajtura me kujdes.<br><br>*Vizita në institucion- Takimin në sekretarinë mësimore;*<br>*RVB;*<br>*Aneksi 5.2. Të dhëna statistikore për studentët MTM.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | UNIKO dhe FE disponojnë dokumentacion të plotë dhe periodik për statistikat vjetore të studentëve të regjistruar, ata që janë tërhequr nga programi, ata që janë larguar para përfundimit të tij, si dhe për studentët që nuk e përfundojnë vitin akademik me sukses.<br>Në Rregulloren e Sektorit të Studimeve dhe të Sektorit TIK, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, organizimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti që lidhet me studentët.<br>Të dhënat mbi studentët ruhen dhe përditësohen me saktësi në bazën e të dhënave të sistemit PITAGORA. Këto të dhëna pasqyrohen në: raportet e analizës së veprimtarisë mësimore të DMT (përfshirë numrin e studentëve të regjistruar, të |

| | |
|---|---|
| | ç'regjistruarve, studentëve që përfitojnë bursë, të dhëna mbi diplomimin dhe vlerësimin e cilësisë së studentëve për çdo vit dhe për çdo program studimi që mbulon Departamenti); raportet e analizës së veprimtarisë mësimore të FE (për çdo vit dhe për çdo program studimi që mbulon FE); dhe në raportet e vlerësimit të NJSBC.<br><br>*Vizita në institucion- Takimi në sekretarinë mësimore;*<br>*RVB;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.10. Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK.* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Gjatë vizitës në Institucion dhe sekretarinë mësimore, GVJ shqyrtoi regjistrat dhe konfirmoi informacionin në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin ç'regjistruar dhe ata me status aktiv.<br>Sekretaria mësimore e programit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" ka regjistra të përditësuar dhe të saktë për çdo student, duke përfshirë informacionin për numrin e të regjistruarve, të ç'regjistruarve, largimet, etj.<br>Gjithashtu, përmes sistemit PITAGORA, institucioni mund të gjenerojë statistika në çdo moment, duke mundësuar akses dhe monitorim efikas të të dhënave. Ky sistem është i mbrojtur nga ndërhyrjet e jashtme (hacking) dhe të dhënat e tij përpunohen duke respektuar Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Rregulloren për Mbrojtjen, Ruajtjen dhe Përpunimin e të Dhënave Personale.<br><br>*Vizita e GVJ në sekretarinë mësimore;*<br>*RVB;*<br>*Evidenca 1.9. Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të | UNIKO kontrollon në mënyrë periodike në nivel Fakulteti dhe Universiteti, të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit në lidhje me studentët dhe veprimtaritë e tyre. Në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga vizita e GVJ-së në Institucion vërtetohet që Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për të kryer kontrollet periodike. ***Në dokumentet e dorëzuara nuk ka raporte të auditit të brendshëm, por vetëm ato të kryera nga MAS dhe KLSH.***<br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO* |

| | |
|---|---|
| dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | *Evidenca 1.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Aneksi III.01. Model pyetësori studentor;*<br>*Aneksi III.02. Raporte vjetore të Vep. së DMT;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i Vlerësimit të brendshëm të FE.* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Në nivel departamenti, çdo vit akademik hartohen raporte mbi veprimtarinë mësimore, ku paraqiten tregues për profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve për çdo program studimi. Në këto raporte analizohet gjendja aktuale, bëhet krahasimi me vitet e kaluara, identifikohen shkaqet dhe parashikohet një plan veprimi për përmirësimin në të ardhmen. Këto raporte përfshihen në raportin vjetor mbi veprimtarinë mësimore të UK, duke u bërë pjesë e një plani masash në nivel institucional.<br>QKA në UK harton raporte mbi ecurinë e studentëve të diplomuar, ku paraqiten të dhëna mbi punësimin e studentëve që kanë përfunduar studimet në UK. Po ashtu, NJSBC harton çdo vit "Raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë", i cili përmban informacion të detajuar mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe në lidhje me punësimin e tyre. Raporti shoqërohet me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.<br><br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO*<br>*Aneksi I.10. Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe TIK;*<br>*Aneksi III.02. Raportet vjetore të DMT;*<br>*Aneksi II.06. Të dhëna nga Sektori i Studimeve dhe TIK;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i Vlerësimit të brendshëm të FE.* |
| **Konkluzione** | *Pas shqyrtimit të informacioneve mbështetëse në dokumentet e dorëzuara, RVB-së, vizitave dhe takimeve në Institucion, GVJ arrin në përfunimin se UNIKO ka krijuar një praktikë të mirë të administrimit, përditësimit dhe ruajtjes të të dhënave në lidhje me numrin e studentëve, ç'regjistrimet apo transferimet e tyre, ndjekjen e cilësisë së tyre për çdo vit që nga regjistrimi deri në diplomim dhe harton raporte në lidhje me gjetjet nga kontrolli i brendshëm i cilësisë. Raportet ndikojnë në përmirësimin e punës për të ardhmen, duke dhënë sugjerime konkrete.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi V.5**

| **Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Në UNIKO, siç është e parashikuar edhe në Statutin e Institucionit, studentët janë të përfshirë në disa struktura drejtuese si të karakterit mësimor-shkencor, ashtu edhe të shërbimeve. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në disa nga strukturat drejtuese të UNIKO si p.sh: Senatin Akademik; Këshillin e studentëve; Bordin e Administrimit; Strukturat këshilluese të studentëve në nivel njësie bazë në FE; Komisionin e sigurimit të cilësisë të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor etj.<br>Në dokumentacionin shoqërues, RVB dhe nga takimet në Institucion, GVJ konstaton se UNIKO është në zbatim të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar në strukturat e përmendura më lart.<br><br>*Takimi i GVJ-së me studentët në Institucion*<br>*Aneksi I.01. Statuti i UNIKO;*<br>*Aneksi I.18. Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese;*<br>*Aneksi I.17. Rregullore e Këshillit Studentor;*<br>*Evidenca 1.5. Rregullore pwr organizimin dhe funksionimin e DKVI.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Në UNIKO janë marrë masat e duhura për të garantuar përfshirjen e studentëve në organet drejtuese dhe administrative sipas përqindjeve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015. Mënyra e përfshirjes dhe rregullat e tjera janë përcaktuar në Statutin dhe Rregulloren e UNIKO, Rregulloren e FE-së dhe Departamentit ku ofrohet programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje".<br>Në UNIKO, në çdo nivel garantohet zgjedhja e përfaqësuesve të studentëve nëpërmjet një procesi zgjedhor transparent, që garanton barazi dhe pjesëmarrje për të gjithë. Përfaqëimi i tyre në këto struktura ndikon në vendimmarrje dhe përmirëson shërbimet ndaj studentëve.<br>Në UNIKO, studentët janë të organizuar në Këshilla studentor si në nivel njësie kryesore, ashtu edhe në nivel institucional. Veprimtaria e tyre rregullohet sipas parashikimeve në Rregulloren e Këshillit Studentor. Çdo grup mësimor në FE |

| | |
|---|---|
| | zgjedh dy senatorë për t'i përfaqësuar në Këshillin Studentor të FE-së. Ky Këshill promovon dhe koordinon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese të UNIKO, në struktura mësimore, kërkimore dhe shërbimeve. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozon zgjidhje për të gjitha çështjet me interes të përgjithshëm të Universitetit, si: planet dhe programet e studimeve, rregulloret e veprimtarisë mësimore, cilësinë e shërbimeve, si dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive.<br><br>*Takimi i GVJ-së me studentët në Institucion*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.18. Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve UNIKO;*<br>*Evidenca 1.17. Rregullorja e Këshillit Studentor;* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Një nga format e përfshirjes së studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes një sondazhi studentor, i cili dërgohet nga NJSBC dhe SKVIA të UNIKO. Pyetësori përmban rubrika të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies, metodat e përdorura, materialet mësimore dhe aspekte të tjera. Në këtë sondazh, studentët kanë mundësinë të shprehin shqetësimet e tyre dhe të sugjerojnë ndryshime apo përmirësime të mundshme.<br>Sipas RVB dhe takimeve në Institucion, në përfundim të çdo viti akademi organizohet rishikimi periodik i programit të studimit, ku i kushtohet vëmendje e veçanta mendimit të studentëve. Këto mendime përcillen në Këshillin studentor të FE-së dhe më pas në organet drejtuese të Fakultetit ose edhe deri në Senatin akademik.<br>***Gjithsesi, GVJ vëren se në dokumentacionin e dorëzuar ka vetëm model të pyetësorit dhe nuk ka dokument me rezultatet e ndonjë pyetësori të realizuar me studentët.***<br>***GVJ sugjeron që pyetësorët të zhvillohen me frekuencën që deklarohet dhe rezultatet e tyre të bëhen publike edhe në faqen zyrtare të internetit të UNIKO ose FE.***<br><br>*Takimet e GVJ-së në Institucion;*<br>*Aneksi III.01. Model pyetësor studentor.* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e | Gjatë vizitës në Institucion dhe takimit të GVJ-së me studentët dhe stafin akademik, si dhe nga dokumentet e dorëzuara dhe RVB, konstatohet se UNIKO dhe Departamenti i Marketingut - Turizmit, ku ofrohet programi Bachelor në "Menaxhim në |

| | |
|---|---|
| kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Turizëm dhe Mikpritje", respektojnë dhe ushtrojnë të drejtat e studentëve për të shprehur lirshëm opinionet e tyre për çështje që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, si dhe për çështje të tjera, si për shembull: etika në komunikim, ankimimin e rezultateve dhe reagimin e institucioneve, njësive, pedagogëve etj.<br>FE dhe Departamenti i Marketing-Turizëm sigurojnë një proces transparent për kontrollin dhe vlerësimin e dijeve, duke informuar studentët për procedurat përmes rregulloreve të brendshme dhe prezantimit të tyre në fillim të çdo semestri nga pedagogu i lëndës, duke përfshirë vlerësimin e vazhduar, zhvillimin e provimeve dhe përcaktimin e rezultateve përfundimtare.<br>Dokumentet e ndryshme pasqyrojnë barazinë dhe sigurojnë transparencën gjatë vlerësimit dhe kontrollit, si pasqyra e vlerësimit të studentëve, regjistrimi i të dhënave në sistemin PITAGORA dhe procedura e ankimimit (të cilat janë të detajuara në rregulloret e brendshme).<br>Studentët mund të shprehin mendimet e tyre dhe të vlerësojnë drejtësinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit përmes pyetësorëve studentorë dhe procedurës së ankimimit. Procedura e ankimimit shpjegohet gjithashtu në rubrikën Programi i Transparencës në faqen zyrtare online të UNIKO.<br>Në takimet e GVJ me drejtues dhe studentë, u shprehën se kanë pasur raste të ankesave të studentëve dhe procedurën e përdorur për adresimin e tyre dhe marrjen e masave konkrete.<br><br>*Takimi i GVJ-së me studentët në Institucion*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Aneksi III.01. Model pyetësor studentor.* |
| **Konkluzione** | *Në përmbyllje të analizës së dokumentacionit të dorëzuar për Standardin V.5, shënimeve nga vizita dhe takimet e GVJ-së në Institucion, si dhe konsultimit të RVB-së dhe faqes zyrtare online të UNIKO, konfirmohet se Institucioni dhe njësitë e tij sigurojnë angazhim të studentëve në organet drejtuese dhe këshilluese. Studentëve u jepet mundësia të përfshihen në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, propozimin e metodave të mësimdhënies, si dhe sugjerime për përmirësimin e burimeve dhe shërbimeve të ndryshme.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Në UNIKO dhe FE ekziston një sistem i strukturuar për informimin dhe orientimin e studentëve. Sipas dokumenteve të dorëzuara, RVB-sw, faqes zyrtare online dhe vizitave të GVJ-së në Institucion, është vënë re se informacioni shpërndahet në forma të ndryshme dhe se UNIKO, si dhe strukturat e tjera të tij, bëjnë përpjekje që ai të jetë i arritshëm për çdo student.<br>Informacioni në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloret e brendshme, procedurat për aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, vendimet e marra nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati dhe Dekanati që kanë lidhje me studentët, si dhe rezultatet e analizave të realizuara, komunikohen kryesisht përmes faqes zyrtare të UNIKO, e cila është e aksesueshme nga të gjithë në çdo kohë. Po ashtu, informacioni shpërndahet nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me studentët, platformave online, të cilat janë të disponueshme për pedagogët dhe studentët.<br>Promovimi i programeve të studimit nga QKA në bashkëpunim me njësinë përkatëse realizohet përmes fletëpalosjeve dhe publikimeve të FE-së, stendave informuese të vendosura në mjediset e FE, si dhe video-ve reklamuese dhe materialeve që transmetohen në monitorët e vendosur në mjediset e FE.<br><br>*Vizita dhe takimet e GVJ-së në Institucion;*<br>*RVB;*<br>*https://unkorce.edu.al/* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | UNIKO dhe FE sigurojnë shpërndarjen e informacionit, këshillimin e studentëve dhe ndjekjen e përparimit të tyre përmes disa strukturave të stabilizuara dhe funksionale, si: Zyra e Informimit dhe Orientimit të Studentëve në FE, e cila ka si qëllim përmbushjen e nevojave të studentëve dhe orientimin e tyre në lidhje me çështje dhe problematika të ndryshme. Kjo zyrë ofron mbështetje për studentët e rinj, duke i këshilluar dhe asistuar ata në lidhje me kërkesat e programeve të studimit, progresin akademik dhe i informon për çdo pyetje ose kërkesë që mund të kenë.<br>Në UNIKO, për informimin dhe këshillimin e studentëve është funksionale edhe Këshilli Studentor, i cili, në bashkëpunim me njësitë përkatëse, ndihmon në shpërndarjen e informacionit në |

| | |
|---|---|
| | mënyrë më efikase dhe në përfshirjen e studentëve në aktivitete të ndryshme.<br>Në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe informacionit për studentët, QKA në UNIKO mbështet dhe asiston studentët jo vetëm gjatë periudhës së studimeve, por edhe pas përfundimit të tyre. Ajo është e fokusuar në ruajtjen e një lidhjeje të vazhdueshme dhe ofron informacion të shumtë, që përfshin studimet, programet e ndryshme, orientimin për karrierën dhe këshillimin, si në grupe, ashtu edhe individualisht.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Aneksi I.28. Analiza e veprimtarisë së QKA-së;*<br>*Evidenca 1.17. Rregullorja e Këshillit Studentor.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Në UNIKO është funksionale Qendra e Këshillimit dhe Alumni (QKA), e cila, si pjesë e strukturës organizative të institucionit, ofron shërbime për studentët me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin e potencialeve që do t'i ndihmojnë ata në tregun e punës. QKA përgatit dhe shpërndan planin e punës dhe kalendarin e aktiviteteve në fillim të çdo viti akademik.<br>Disa nga aktivitetet kryesore të organizuara dhe të planifikuara nga QKA në UNIKO përfshijnë:<br>- *Ofrimin e orientimit paraprak për maturantët* që janë kandidatë për studentë dhe organizimin e promovimit të programeve të studimit (përfshirë objektivat, mundësitë e punësimit, kriteret e pranimit dhe infrastrukturën e disponueshme) në shkollat e mesme të rajonit.<br>- *Bashkëpunimin me njësitë bazë* dhe organizimin e takimeve orientuese për studentët e vitit të parë, për t'i informuar ata mbi programet e studimit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, sistemin e krediteve, vlerësimin, dhe informacionet e tjera të nevojshme.<br>- *Ofrimin e informacionit dhe orientimit për procesin mësimor*, duke ofruar mbështetje profesionale për shkrimin e detyrave/projekteve të kursit, temave të diplomës dhe përdorimin e metodave të duhura për citimin e punimeve shkencore.<br>- *Shpërndarjen e informacionit mbi mundësitë për bursa* jashtë vendit, seminare, workshop-e, si dhe ofrimin e ndihmës për aplikimet për mobilitete dhe lehtësimin e procedurave të transferimit të krediteve.<br>- *Informimin e studentëve për aktivitetet plotësuese* që mbështesin procesin mësimor në faqen e internetit të |

| | |
|---|---|
| | UNIKO (në kategoritë Njoftime dhe Veprimtari) dhe në ambientet fizike të QKA.<br>- *Shërbimin si një lidhje ndërmjet punëdhënësve dhe studentëve*, përfaqësimin e UNIKO-s në panairin e punës dhe mbështetjen e studentëve në zhvillimin e praktikave profesionale ose internship-eve.<br>- *Orientimin e studentëve në procesin e kërkimit të punës*, duke ofruar trajnime, forume dhe këshillime për t'i ndihmuar ata të njohin veten e tyre, të specifikojnë interesat dhe të vlerësojnë aftësitë, të kuptojnë tregun e punës dhe mundësitë e punës që shpallen në mediat sociale.<br>- *Ofrimin e mbështetjes* në procesin e përgatitjes së CV-së, shkrimin e letrës së interesit dhe përgatitjen për intervistat e punës.<br>Aktivitetet e QKA zhvillohen në bashkëpunim me njësitë bazë dhe janë të diferencuara sipas fushës dhe nivelit të studimit të studentëve. Në takimet me studentët, ata konfirmuan se shumica e aktiviteteve të parashikuara nga QKA janë realizuar në UNIKO.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Aneksi I.28. Analiza e veprimtarisë së QKA-së;* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ, duke u bazuar në RVB dhe takimet në Institucion, konstaton se menaxhimi i Rrjetit Alumni të UNIKO dhe FE drejtohet nga QKA, e cila fokusohet në mbështetje për zhvillimin profesional të studentëve të diplomuar. QKA krijon mundësi për t'i lidhur ata me punëdhënës të mundshëm, duke promovuar studentët dhe ndihmuar ata në gjetjen e mundësive të reja të punës. Po ashtu, ajo mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, duke krijuar dhe përditësuar vazhdimisht një bazë të dhënash mbi punësimin e tyre.<br>Në faqen e saj të internetit, UNIKO publikon informacione të rregullta për studentët e ekselencës, duke promovuar mundësitë më të mira përballë kërkesave të tregut të punës. Studentët e diplomuar, të cilët janë pjesë e Rrjetit Alumni, përfshihen nga QKA në aktivitete të ndryshme, që krijojnë lidhje të qëndrueshme mes tyre dhe studentëve aktualë. QKA kontribuon gjithashtu në shpërndarjen e ideve, iniciativave, inovacionit dhe bashkëpunimeve mes studentëve, me qëllim përballimin e sfidave të tregut të punës.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Aneksi I.28. Analiza e veprimtarisë së QKA-së;* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *UNIKO ka në funksion QKA dhe njësi të tjera mbështetëse, të cilat organizojnë aktivitete të ndryshme për orientimin dhe këshillimin e studentëve, duke i shoqëruar ata që nga regjistrimi dhe gjatë gjithë periudhës së studimeve, deri në diplomim dhe më pas. Po ashtu, QKA merret me menaxhimin e ankesave dhe problemeve që studentët mund të hasin dhe siguron adresimin e këtyre çështjeve në kohë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Sipas RVB dhe nga vizita e GVJ-së në Institucion, është vënë re se UNIKO ka vëmendje të veçantë për cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e metodave të reja. Shumica e sallave janë pajisur me teknologji moderne për të rritur ndërveprimin gjatë mësimit dhe për të përdorur ilustrime, video dhe prezantime të ndryshme. Për përmirësimin e komunikimit me studentët është përpiluar edhe manuali përdorimit të sistemit PITAGORA.<br>Në faqen zyrtare online të UNIKO është një rubrikë e veccantë e kushtuar platformave të ndryshme digjitale ose LMS për të cilat janë vendosur manualet përkatëse dhe ofrohet ndihmë, në mënyrë që të rritet përdorimi i tyre si nga pedagogët, ashtu edhe nga studentët etj. Ndër platformat dhe aplikacionet digjitale, për të cilat ka manual janë: Google classroom, Google meet; Edumeet; Moodle etj.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion në sallat e leksioneve, seminareve, laboratore etj;*<br>*Evidenca 1.6.1. Manual i sistemit elektronik PITAGORA;*<br>*https://edu.google.com/for-educators/overview/?modal_active=none#level0-topvideo;* |

| | |
|---|---|
| | *https://www.docdroid.net/XXA7fWr/manual-edumeet-1-pdf.* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Manuali i cilësisë të UNIKO është hartuar në përputhje me Statutin e tij dhe rregulloret e tjera në fuqi. Ky Manual pasqyron parimet kryesore të funksionimit të strukturës së cilësisë në institucion. Ai është një dokument i rëndësishëm për mirëfunksionimin e Institucionit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të toj. Në të përshkruhet korniza, strukturat, parimet, procedurat dhe standardet e sigurimit të cilësisë dhe është pjesë integrale e punës së përditshme të stafit të UNIKO. Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave i krijuar në UNIKO është përgjegjës për ngritjen, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në këtë Universitet. Funksionimi i këtij sektori mbështetet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe në standardet dhe udhëzimet europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë.<br>Nga takimet e GVJ-së me studentët, stafin dhe përfaqësuesit e Sektorit të Cilësisë, konfirmohet se kjo njësi realizon procesin e monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë në veprimtaritë mësimore dhe kërkimore shkencore. Sipas RVB-së, kjo njësi kryen gjithashtu pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit, si dhe organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve dhe të vlerësimit institucional të brendshëm.<br>Po ashtu, UNIKO ka krijuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në Universitet.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion dhe RVB;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i cilësisë së UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e FE-së;*<br>*Evidenca 1.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Aneksi VI.01. Vendim për ngritjen e GVB;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE;*<br>*https://unkorce.edu.al/26223-2/* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin | Në statutin e UNIKO garantohen mundësitë për përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të mësimdhënies në përgjithësi duke u fokusuar në metodat dhe format e |

| | |
|---|---|
| periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit, sugjerimet për përmirësim etj. Kjo realizohet përmes pjesëmarrjes së përfaqësuesve të studentëve në organet drejtuese në nivel institucional dhe në njësitë kryesore, si dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, duke ushtruar të drejtën e ankimimit të rezultateve të vlerësimit të dijeve, etj.<br>Në takimet me drejtues të Institucionit u përmendën raste kur studentët kanë ushtruar të drejtën e tyre për ankimim dhe që në bazë të tyre dhe procedurave të tjera për verifikimin e rastit, janë marra masa ndaj pedagogëve për të cilët ishin ankimimet.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion dhe RVB;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i cilësisë së UNIKO;*<br>*Aneksi VI.01. Vendim për ngritjen e GVB;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE;*<br>*https://unkorce.edu.al/26223-2/* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | UNIKO, përmes SSCK, siguron që Fakultetet dhe njësitë bazë të paraqesin raporte periodike mbi vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të tyre. Miratimi i paketës së instrumenteve matës të cilësisë e lehtëson dhe standardizon këtë proces për çdo hallkë të Universitetit.<br>Vlerësimi i pedagogëve bëhet çdo vit në fund të periudhës, duke u mbështetur në manualin e performancës, dhe duke analizuar rishikimin e CV-ve të përditësuara dhe dosjeve përkatëse që dorëzohen në degën e Burimeve Njerëzore në UNIKO. Përmes faqes zyrtare, UNIKO pasqyron në mënyrë transparente dhe bën publike politikat, strategjinë, organizimin dhe aktivitetet e tij për studentët dhe të gjithë të interesuarit.<br>***GVJ vizitoi faqen zyrtare të internetit të UNIKO dhe në rubrikën Programi i Transparencës ka mungesa të disa dokumenteve të rëndësishme, të cilët ekszistojnë si emërtime dhe link, por nuk janë të aktivizur. Sugjerohet që të publikohen të gjithë informacionet dhe dokumentet që parashikohen të jenë publike.***<br><br>*Vizita e GVJ-së në Institucion;*<br>*https://unkorce.edu.al/archive/programi_transparences/ programi_i_transparences.php#*<br>*Evidenca I.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i cilësisë së UNIKO;* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të | UNIKO është impenjuar për të siguruar të gjithë mekanizmat e nevojshëm për të realizuar vlerësimin e personelit akademik |

| | |
|---|---|
| vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | dhe të mësimdhënies. UNIKO, FE dhe DMT promovojnë shembujt e praktikave të mira në takime dhe organizime të ndryshme, në mënyrë që të nxitet edhe pjesa tjetër e stafit. Gjithashtu organizohen edhe trajnime dhe seanca informuese për aktivitete të ndryshme ose për aplikime. Të dhënat në raportet e vlerësimit përdoren për nxitjen e ndryshimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme.<br>***GVJ konstaton se shumica e aktiviteteve dhe promovimeve mbeten në nivel njësie kryesore dhe më pak janë në nivel njësie bazë. Gjithashtu, sugjerohet që të këtë vlerësime dhe analiza të punës kërkimore në mënyrë periodike dhe të pasqyrohen rezultatet me qëllim promovimi dhe nxitje për përmirësimin e veprimtarisë kërkiomore-shkencore.***<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Aneksi I.33. Leksione të hapura;*<br>*Aneksi IV.07. Aktiviteti kërkimor-shkencor i DMT* |
| **Konkluzione** | *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe vizita e GVJ në Institucion dhe takimet me studentët e stafin, arrin në përfundimin se standardi 1 i fushës VI, përmbushet kryesisht, pasi disa elementë të tij mbeten të zbatuara vetëm në nivel Institucioni dhe nuk janë në nivel Njësie Kryesore ose Njësie Bazë. Një pjesë e madhe e dokumenteve që duhet të jenë publike nuk janë të publikuara në faqen zyrtare.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Në Statutin e UNIKO, duke u bazuar në Ligjin e Arsimit 80/2015, përcaktohet përgjegjësia e Institucionit për sigurimin e cilësisë në të gjitha njësive të tij organizative. Për këtë qëllim, është organizuar dhe funksionon rrjeti i cilësisë që është përgjegjës për ngritjen, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UNIKO. Politika për sigurimin e cilësisë në këtë Institucion është publike dhe përfshihet në Planin Strategjik të Zhvillimit të tij.<br>Njësitë dhe aktorët e brendshëm të institucionit janë të angazhuar në zhvillimin dhe zbatimin e kësaj politike, përmes |

| | |
|---|---|
| | standardeve, strukturave dhe procedurave të shqyrtuara dhe miratuara nga organet kolegjiale. Standardet për sigurimin e cilësisë në UNIKO hartohen në përputhje me Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, si dhe me standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.<br><br>*Aneksi I.01 - Statuti i UK;*<br>*Aneksi I.03 - Planit Strategjik të Zhvillimit të UK* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | UNIKO ka në fokus të punës marrjen e masave dhe vënien në funksionim të strukturave të ndryshme për të siguruar mbarëvajtjen e programeve të studimit me instrumenta të ndryshëm matës. Duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara dhe dhe vizita e GVJ-së në Institucion, vërtetohet se Institucioni harton raporte përmbledhëse në lidhje me veprimtarinë dhe kualifikimin e stafit akademik. Gjithashtu hartohen dhe shpërndahen pyetësorë të studentët që të japin mendimin e tyre në lidhje me mësimdhënien etj. Disa nga raportet bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Universitetit.<br>Në UNIKO, për sigurimin dhe menaxhimin e rrjetit të cilësisë janë përgjegjëse SKVIA dhe DKVI. Si pjesë e këtij sektori funksionon edhe NJSBC, e cila ka një koordinator nga çdo njësikryesore. Çdo njësie kryesore i është caktuar një grup vlerësimi i brendshëm, i cili përfshin përfaqësues nga çdo njësi bazë dhe përfaqësues të studentëve. Organizimi dhe funksionimi i NJSBC përcaktohet në Statutin e UK dhe në Manualin e Cilësisë. Fokusi i veprimtarisë së NJSBC është i përcaktuar në Rregulloren e DKVI dhe rezultatet e aktiviteteve të saj publikohen në faqen zyrtare të Universitetit.<br>Nga takimet e GVJ në Institucion me studentët, stafin dhe përfaqësues të Sektorit të Cilësisë, konfirmohet fakti se kjo njësi kryen procesin e monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe promovimit të cilësisë së veprimtraive mësimore e kërkimore shkencore.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion dhe RVB;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i cilësisë së UNIKO;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e FE-së;*<br>*Evidenca 1.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Aneksi VI.01. Vendim për ngritjen e GVB;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE;*<br>*https://unkorce.edu.al/26223-2/* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | Manuali i Cilësisë i UNIKO është një nga instrumentet udhërrëfyes për procedurat e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin e efektivitetit të aktiviteteve të zhvilluara nga çdo aktor përgjegjës në sigurimin e cilësisë dhe përmbushjen e standardeve në njësitë përbërëse të Universitetit.<br>Në përputhje me studimet dhe zhvillimet e tregut, UNIKO ka përmirësuar kurrikulën, ka investuar në infrastrukturë, veçanërisht në rrjetet e teknologjive të komunikimit dhe ka përditësuar faqen e saj elektronike. Po ashtu, ka krijuar mundwsinw pwr akses në bibliotekën digjitale dhe literaturë bashkëkohore. Gjithashtu, është përfshirë një gamë e gjerë palësh të interesuara, si grupet e interesit, studentët e diplomuar dhe punëdhënësit, të cilët janë pjesë e komisioneve për sigurimin e cilësisë dhe janë angazhuar në sondazhe, takime, intervista dhe diskutime mbi rezultatet e siguruara nga procesi i sigurimit të cilësisë.<br>Vlerësimi i jashtëm menaxhohet nga ASCAL dhe mbështetet gjithashtu në raportet e vetëvlerësimit. Gjithashtu nga MAS dhe KLSH kryhen herë pas here kontrolle dhe raportet jane të përfshira në dokumentacionin e dorëzuar. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet SKS është një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të jashtëm të cilësisë.<br>UK është një institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 02, datë27/01/2023.<br>UK monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS), organizuar nga ASCAL.<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion dhe RVB;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i cilësisë së UNIKO;*<br>*https://unkorce.edu.al/26223-2/*<br>*Evidenca 1.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Aneksi VI.01. Vendim për ngritjen e GVB;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE;* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. | Departamenti i Marketing-Turizmit në UNIKO, kryen procesin e rishikimit të kurrikulave dhe analizat mësimore dhe i dërgon propozimet në instancat më të larta sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Pasi kalohen në Senat dhe Rektorat, merren vendime në lidhe me kërkesat e parashtruara për ndryshime, të cilat duhe të shoqërohen me argumentet përkatëse. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | Më pas vendimet e marra u komunikohen departamenteve dhe strukturave përkatëse për zbatimin e tyre. Përveç Departamentit pyetësorë dhe analiza për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe nxitjesa të praktikave të mira, realizon edhe NJBSC me struktrat e saj përkatëse.<br><br>*Vizita e GVJ-së në Institucion;*<br>*Evidenca 1.1.Statuti i Universitetit "Fan Noli", Korçë;*<br>*Evidenca 1.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE-së.*<br>*https://unkorce.edu.al/ëp-content/uploads/2022/04/RELACION-PYETESORI-PER-SEZONIN-E-PROVIMEVE-TE-VERES.pdf;*<br>*Aneksi III.02. Raporte vjetore të Veprimtarisë së Departamentit të Marketing-Turizmit;*<br>*Aneksi III.15. Programe të ngjashme ndërkombëtare me Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje.* | | | |
| **Konkluzione** | *Nga takimet në Institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar GVJ arrin ne përfundimin se Institucioni përdor tregues të ndryshëm dhe të matshëm për përmirësimin e kurrikulës dhe për të promovuar arritjet më të mira të programit. Gjithashtu, departament i Marketing-Turizëm ku ofrohet programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" organizon pyetësorë me studentët dhe përpiqet të pasqyrojë kërkesat e tyre dhe ankesat në nivelet e tjera drejtuese.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të | Departamenti i Markteting-Turizmit në FE, UNIKO, është përgjegjës për rishikimin e programeve të studimit, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore, si dhe Rregulloren e Brendshme të Fsë.<br>Në vizitën në Institucion dhe nga takimet me stafin akademik dhe përfaqësues të strukturave të ndryshme si dhe nga RVB e dokumentacioni shoqërues, GVJ u informua ky process |

| | |
|---|---|
| programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | realizohet çdo vit akademik, ku stafi akademik, drejtuesi i njësisë bazë dhe koordinatori i programit të studimit diskutojnë dhe propozojnë ndryshime përkatëse në programin e studimit dhe rregulloren mësimore. Gjatë këtij rishikimi, merren parasysh konkluzionet e studimeve të tregut të punës, opinioni i studentëve (përmes rezultateve të pyetësorëve studentorë), relacionet e pedagogëve për lëndët dhe modulet që mbulojnë, si dhe sugjerimet nga punëdhënësit dhe studentët e diplomuar. Pas përgatitjes së relacionit përkatës, ndryshimet e propozuara shqyrtohen dhe miratohen nga Dekanati.<br>Përveç kësaj, Fakulteti, bazuar në Rregulloren e Brendshme, kryen rishikimin periodik të programeve të studimit dhe rregulloreve mësimore. Kjo përfshin edhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të ecurisë së procesit mësimor dhe mbledhjen e opinionit të studentëve përmes pyetësorëve.<br>Në nivel institucional, SKVIA mbikëqyr dhe orienton përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë. Ky sektor ndihmon në zhvillimin dhe implementimin e strategjive të përmirësimit dhe ndihmon në ndryshimet që bëhen në përputhje me nevojat e tregut dhe kërkesat akademike.<br>Për të vlerësuar ecurinë e programeve të studimit, UNIKO përdor instrumente të ndryshme vlerësuese, si pyetësorët dhe studimet përkatëse që drejtohen ndaj studentëve, stafit akademik dhe administrativ, si dhe palëve të interesuara si punëdhënësit dhe studentët e diplomuar. Pas mbledhjes së të dhënave nga këto pyetësorë, NJSBC harton raporte që pasqyrojnë rezultatet e vlerësimit dhe sugjerimet për përmirësim. Ecuria e programeve të studimit monitorohet në vijimësi dhe vlerësohet përmes analizave të treguesve të matshëm, si numri i studentëve të regjistruar, shkalla e kalueshmërisë dhe numri i studentëve të diplomuar, si dhe nga rezultatet e pyetësorëve dhe raportet e vlerësimit të NJSBC.<br><br>*Takimet e GVJ-së në me stafin dhe përfaqësues të zyrave;*<br>*Evidenca 1.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE-së.*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/04/RELACION-PYETESORI-PER-SEZONIN-E-PROVIMEVE-TE-VERES.pdf;*<br>*Aneksi III.02. Raporte vjetore të Veprimtarisë së Departamentit të Marketing-Turizmit;* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | UNIKO zbaton një politikë të caktuar për sigurimin e cilësisë deri në nivel departamenti, nëpërmjet kontrollit dhe vlerësimit të pedagogëve (të rinj dhe me përvojë), në bazë vjetore, analizës së rezultateve dhe hartimin e raporteve përkatëse. UNIKO ka strukturat e posaçme të cilat hartojnë Raportet vjetore institucionale dhe raportet e vlerësimit të cilësisë. Raportet vjetore të veprimtarisë të DMT përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive dhe parashikimet për periudhat e ardhshme. Në bazë të procedurave për analizimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe lëndëve të programit të studimit, përpilohen më pas projekt propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë në të gjitha strukturat.<br><br>*Takimet e GVJ-së në me stafin dhe përfaqësues të zyrave;*<br>*Aneksi III.02. Raporte vjetore të Veprimtarisë së Departamentit të Marketing-Turizmit;*<br>*Aneksi VI.02. Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE-së.*<br>*https://unkorce.edu.al/26223-2/;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | NJBSC në UNIKO realizon kontrollin dhe vlerësimin e programeve të studimit. Çdo vit përpilohen raporte vjetore, të cilat vlerësojnë ecurinë e programeve të studimit. Procedura e kontrollit, vlerësimit dhe përmirësimit të kurrikulës dhe programeve të studimit që ofrohen nga NJBSC dhe FE përfshin rishikimin e tyre dhe të syllabuseve në fillim të vitit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit dhe anëtarët e stafit akademik, duke pasur parasysh edhe rekomandimet nga viti i mëparshëm. Rezultatet e vëzhgimeve, pyetësorëve etj., diskutohen në mbledhjet e departamentit, ku inkurajohen dhe promovohen praktikat pozitive, ndërsa diskutohet ose merren masa për ndryshimin e rasteve me probleme dhe vështirësi në mësimdhënie.<br>Përgjegjësi i Departamentit, në bashkëpunim me titullarët e lëndëve në Njësitë Bazë, mbikëqyrin dhe monitorojnë respektimin e programeve të mësimdhënies, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera, ndjekin aktivitetet mësimore dhe shkencore të stafit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe vëzhgojnë studentët gjatë zhvillimit të seancave laboratorike, detyrave të kursit, testimeve etj.<br>Vlerësimet dhe rekomandimet për ndryshime, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, vijnë gjithashtu nga SKVI, nëpërmjet Raportit vjetor të realizuar prej saj dhe publikimit të tij. |

| | |
|---|---|
| | *RVB;*<br>*Aneksi III.02. Raporte vjetore të Veprimtarisë së Departamentit të Marketing-Turizmit;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2024/07/2023-2024-Plani-i-Punes-NJSBC.pdf* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga vizita e takimet në Institucion, GVJ konstaton se UNIKO dhe njësitë përbërëse të tij në çdo nivel përdorin metoda dhe instrumente të tërthortë për të realizur vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit, duke përdorur metoda të ndryshme vlerësimi. Metoda më e përdorur është pyetësori ose sondazhi, që u dërgohet online studentëve, për të ruajtur anonimatin. Në fund të çdo semestri, çdo pedagog i departamentit Marketing-Turizëm zhvillon me studentët pyetësorin për vlerësimin e lëndës/modulit që ai mbulon.<br>Departamenti gjithashtu kryen analizën e studimit të tregut, i cili synon vlerësimin e opinionit të studentëve (aktualë dhe të diplomuar), mendimin e punëdhënësve dhe shkallën e interesit të maturantëve për programin e studimit. FE dhe DMT vlerësojnë komentet formale të studentëve dhe zhvillojnë takime periodike me personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, si dhe takime me alumni dhe punëdhënës në rajon, për të adresuar shqetësimet e shprehura në sondazhe dhe për të përshtatur programin në përputhje me kërkesat e tregut.<br>Gjithashtu, në nivel Fakulteti realizohen pyetësorët studentor në fund të çdo semestri ose para sezonit të provimeve, për modulet e çdo programi studimi.<br>QKA, çdo vit nxjerr të dhënat e gjurmimit të studentëve që kanë përfunduar vitin akademik paraardhës dhe përditëson të dhënat e bazës së punëdhënësve.<br><br>*Aneksi III.01. Model pyetësori studentor;*<br>*Aneksi III.02. Raporte vjetore te Veprimtarisë së DMT;*<br>*Aneksi I.28. Analiza e Veprimtarisë së QKA;*<br>*Aneksi I.27. Studime tregu.* |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se Institucioni ka ngritur njësitë e posaçme për të realizuar monitorimin dhe vlerësimin periodik të programeve të studimit dhe harton raporte për përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të studimit si dhe për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të të nxënit. Çdo vit përpilohen raporte vjetore, të cilat vlerësojnë ecurinë e programeve të studimit. Gjithashtu nxjerr të dhënat e gjurmimit* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *të studentëve që kanë përfunduar vitin akademik paraardhës dhe përditëson të dhënat e bazës së punëdhënësve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | UNIKO në Manualin e Cilësisë dhe në rregulloret në fuqi përcakton procedurat që garantojnë sigurimin e cilësisë. Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UNIKO është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) me sektorët përkatës. Në rregulloren e UNIKO, të FE-së, Departamentit të Marketing-Turizmit; të DKVI-së etj. si dhe në Manualin e Cilësisë përcatohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të angazhuara në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Gjithashtu, përcaktohen dhe hartohen politikat për realizimin e kësaj detyre. Procesi i sigurimit të cilësisë së programit të studimit garantohet edhe me anë të përfshirjes të studentëve në strukturat përkatëse.<br><br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Evidenca 1.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;*<br>*Aneksi I.45. Rregullore e brendshme e DMT;*<br>*Aneksi I.26. Rregullore e Programit të studimit MTM;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i cilësisë së UNIKO* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Në bazë të dokumentacioneve të dorëzuara, atyre të publikuara në faqen zyrtare online të UNIKO dhe vizita e GVJ në Institucion, konstatohet se Universiteti "Fan Noli" në Korçë është i dedikuar për të përmbushur kriterin nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një politike për sigurimin e cilësisë deri në nivel departamenti e programi studimor.<br>Përveç pyetësorëve, përdoren edhe metoda të tjera për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Fakulteti i Ekonomisë dhe departamentet përkatëse përfshihen në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë nëpërmjet bashkëpunimit për hartimin e planit të zhvillimit dhe ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm të |

| | |
|---|---|
| | kurrikulave, syllabuseve, organizimi i leksioneve të hapura dhe nga lektorë të huaj të ftuar etj.<br>NJSBC-ja dhe strukturat e saj krijojnë kushtet dhe mundësitë për të realizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultetin Ekonomik të UNIKO.<br>Në analizat që realizohen nga Fakultetet dhe Departamentet theksohen arritjet si dhe problematikat e hasura dhe merren masa për adresimin e tyre.<br>*RVB dhe takimet e GVJ-së gjatë vizitës në Institucion;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i Cilësisë të UNIKO;*<br>*Aneksi 1.24. Plani i zhvillimit të FE;*<br>*Aneksi III.02. Raporte vjetore të Veprimtarisë së DMT;*<br>*Aneksi I.41. Aktivitete të DMT.* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | Sipas RVB-së dhe takimeve të GVJ-së në Institucion, konstatohet se NJSBC dhe SKVIA në UNIKO kryejnë të gjitha veprimtaritë e parashikuara në Statutin e Universitetit dhe rregulloret e miratuara, për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit. Vlerësimi i sigurisë së cilësisë realizohet edhe nga njësitë bazë e kryesore dhe ka gjithëpërfshirje me përfaqësues nga të gjithë aktorët: stafi akademik, ndihmës akademik, studentët, ekspert të jashtëm etj. Studentët japin kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programeve të studimit edhe në strukturat e tjera ku ata kanë përfaqësues, si psh: Senatin Akademik; Këshillin e Etikës dhe Bordin e Administrimit etj. Gjithashtu, në procesin e vlerësimit të brendshëm periodik ndihmon edhe Këshilli Studentor, i cili merr pjesë në mënyrë aktive në përcjelljen e zërit të studentëve në funksion të përmirësimit të cilësisë, nxitjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve dhe sondazheve etj.<br>Njësia Bazë ngre njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në të cilën përfshihet si anëtar të paktën edhe 1 student. Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë dhe ofrimit të programit të studimit është proces i vazhdueshëm.<br><br>*RVB dhe takimet e GVJ-së gjatë vizitës në Institucion;*<br>*Evidenca 1.15. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i Cilësisë të UNIKO;*<br>*Aneksi VI.01. Grupi i Vlerësimit të brendshëm për Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje;*<br>*Evidenca 1. 17. Rregullorja e Këshillit studentor;* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të | NJSBC-ja e UNIKO, siç parashikohet edhe në Statut dhe Rregulloret e tjera, ka në përbërje përfaqësues nga Fakultetet |

| | |
|---|---|
| brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | (sipas propozimit të tyre), nga studentët dhe ekspert të jashtëm. Palët pjesëmarrëse karakterizohen nga niveli i lartë i integritetit dhe fryma e komunikimit dhe bashkëpunimit në grup, duke siguruar procese të vlerësimit të brendshëm që respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie ndaj personelit dhe studentëve duke respektuar lirinë dhe etikën akademike.<br><br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.2. Rregullorja e UNIKO;*<br>*Evidenca 1.5. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DKVI;*<br>*Evidenca 1.16. Manuali i cilësisë së UNIKO*<br>*Aneksi I.32. Rregullore e brendshme e FE;* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, të dhënave në faqen zyrtare online të Universitetit, vihet re se Institucioni konsultohet dhe kërkon ndihmën edhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm në lidhje me kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë.<br>Për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në Fakultetin Ekonimik dhe Departamentin e Marketing-Turizmit, ku ofrohet programi i studimit Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje", janë ftuar vazhdimisht ekspertë të huaj ose Profesorë që kanë organizuar leksione të hapura. Aktivitete të tilla ndikojnë në rritjen e bashkëpunimit, si dhe në përmirësimin e cilësisë së këtij programi. Gjithashtu, programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" promovohet edhe në panaire, workshope dhe aktivitete të tjera ku marrin pjesë subjekte shtetërore dhe private, të cilët u ofrojnë studentëve pozicionet e tyre vakante dhe japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e tij.<br><br>*RVB dhe takimet e GVJ-së gjatë vizitës në Institucion;*<br>*Aneksi I.41. Aktivitete të DMT;*<br>*Aneksi I.40. Marrëveshje bashkëpunimi të FE-së;*<br>*Aneksi I39. Marrëveshje bashkëpunimi midis UK dhe Universiteteve dhe Institucioneve të tjera* |
| **Konkluzione** | *Nga takimet në institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konkludon se institucioni ka një praktikë funksionale të përfshirjes së personelit akademik dhe jo-akademik, si dhe studentëve, në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe raporton për rezultatet e arritura. Gjithashtu, institucionin fton sipas nevojës edhe ekspertë të* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *jashtëm për të dhënë ekspertizën e tyre lidhur me përmirësimin e programit dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së tij.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Universiteti "Fan Noli" në Korccë dhe njësitë e tij hartojnë strategji dhe politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Pyetësorët që zhvillohen me studentët dhe rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e departamenteve dhe janë publike për stafin si dhe për të gjitha palët e interesuara.<br>Në rubrikën Programi i Transparencës në faqen zyrtare online të UNIKO, bëhen publike të gjithë mekanizmat monitorues si: Planet strategjike të punës, Planet e veprimtarive akademike kërkimore shkencore, Raportet e monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të vlerësimit të brendshëm etj. Këto dhe rezultate nga pyetësorë janë publike edhe në hapësirën e dedikuar Drejtorisë së Kurrikulave dhe Cilësisë. Përvecc dokumenteve të përmendura në rubrikën online Transparenca, ***GVJ, gjatë kontrollit të faqes vuri re se ka edhe dokumente të tjera, që ekzistojnë si emërtim, por nuk janë publike. GVJ sugjeron, që rubrika të kontrollohet periodikisht dhe të përditësohet me informacionet dhe dokumentet e nevojshme, për të siguruar transparencë të plotë.***<br><br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO;*<br>*Evidenca 1.3. Rregullore e UK;*<br>*https://unkorce.edu.al/archive/programi_transparences/programi_i_transparences.php#*<br>*Evidenca 1.3. Plani strategjik i zhvillimit të UK;*<br>*Aneksi I.24. Plani i zhvillimit të FE'* |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe | UNIKO dhe njësitë përkatëse kryejnë rregullisht vlerësimin e programeve të studimit, kryesisht përmes pyetësorëve të cilët u dërgohen studentëve dhe publikojnë rezultatet, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike.<br>NJSBC dhe SKVI janë të ngarkuara me përpunimin e pyetësorëve dhe anketimeve, si dhe me publikimin e |

| | |
|---|---|
| legjislacionin për të dhënat personale. | rezultateve, duke u mbajtur në përputhje me parimin e mësipërm.<br><br>*Evidenca 1.19. Kodi i Etikës së UNIKO;*<br>*Aneksi III.01. Model pyetësori studentor;*<br>*https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/04/RELACION-PYETESORI-PER-SEZONIN-E-PROVIMEVE-TE-VERES.pdf;* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Vlerësime periodike të rezultateve të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore-shkencore realizohen nga të gjitha njësitë e UNIKO. Raportet e përgatitura pasqyrojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor gjatë vitit akademik, si dhe problematikat që mund të lindin në elementë të caktuar të këtyre proceseve. Në bazë të nevojave për përmirësim, të identifikuara gjatë këtyre analizave, DMT, para fillimit të vitit akademik, përpilon një plan veprimi vjetor për të rritur cilësinë e programeve të studimit që ofrohen nga departamenti. Në këtë plan përcaktohen qartë detyrat specifike, përgjegjësitë dhe afatet për realizimin e tyre. FE angazhon dhe informon stafin akademik, administrativ dhe studentët mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.<br><br>*RVB;*<br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>*https://unkorce.edu.al/akreditimi/*<br>*Aneksi VI.03. Programi i Veprimtarisë për mirëvijimin e vitit akademik 2023-2024.*<br>*Aneksi I.24. Plani i zhvillimit të FE;*<br>*Aneksi III.02. Raporte vjetore të veprimtarisë së DMT.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Nga dokumentacioni i dorëzuar, RVB-ja dhe vizita e GVJ-së në Institucion, rezulton se NJSBC-ja e UNIKO, përgatit propozime për përmirësimin e cilësisë për vitin pasardhës, duke u mbështetur gjithashtu në masat e marra një vit më parë. Në raportet e vlerësimit të brendshëm, të përgatitura nga kjo njësit, analizohen pikat e forta dhe të dobëta, duke ofruar propozime për masat që duhen ndërmarrë për realizimin e ndryshimeve. Përmirësimi i cilësisë së punës dhe ofrimi i shërbimeve të ndryshme për UNIKO është mbështetur gjithashtu nga adresimi dhe realizimi i masave për plotësimin e rekomandimeve të dhëna gjatë Akreditimit Institucional.<br>Gjithashtu edhe vetë Departamenti i Marketing-Turizmit ku ofrohet programi Bachelor "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" realizon analiza të punës vjetore dhe përgatit |

| | |
|---|---|
| | raporte, ku parashikohen edhe masat që do të merren për përmirësimin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aspekteve të tjera akademike dhe administrative.<br><br>*RVB dhe Takimet e GVJ-së në Institucion;*<br>*Evidenca 1.1. Statuti i UNIKO*<br>*Aneksi VI.03. Programi i Veprimtarisë për mirëvijimin e vitit akademik 2023-2024.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Strukturat dhe programi i studimit vlerësohen periodikisht nëpërmjet SKVI dhe NJSBC-së. Këto njësi dhe përfaqësuesit e saj japin informacione dhe organizojnë takime informuese në lidhje me aktivitetet e sigurimit të cilësisë në të gjitha njësitë e Universitetit si dhe organizojnë takime informuese në lidhje me ndryshimet dhe përmirësimet e zbatuara dhe të parashikuara.<br>Gjithashtu, Takimet e asamblesë të FE dhe ato të anëtarëve të DMT, kanë për qëllim të informojnë personelin lidhur me arritjet, vlerësimet dhe nevojat për përmirësim të programeve të studimit.<br><br>*RVB;*<br>*Vizita e GVJ në Institucion;*<br>https://unkorce.edu.al/ |
| **Konkluzione** | *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni organizon veprimtari periodike me stafin dhe studentet për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Gjitahstu, Departamenti i Marketing-Turizmit ku ofrohet programi Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" organizon pyetësorë me studentët me qëllim përmirësimin e mësimdhëniese dhe cilësisë së programeve të ofruara. Strukturat e sigurimit të cilësisë dhe organet e tjera drejtuese kanë përfaqësues të studentëve dhe gjithashtu funksionon edhe Këshilli Studentor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti "Fan S. Noli" Korçë".**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Universiteti i Korçës ka një pozitë strategjike në rajonin lindor dhe ka siguruar historikisht mbështetje dhe mundësi më të mëdha studimi për të gjithë studentët nga ky rajon dhe më gjerë.
2. Departamenti i Marketing-Turizmit, që ofron programin Bachelor në "Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje" ka një traditë të gjatë 30-vjeçare dhe është i qendrueshëm e i konsoliduar në programet që ofron dhe cilësinë e stafit dhe studentëve.
3. Ky program është hapur në vitin 1992 dhe është ofruar për herë të parë në Shqipëri nga UNIKO dhe ka një staf akademik të specializuar dhe që merr pjesë rregullisht në trajnime në fushën e turizmit dhe mikpritjes brenda dhe jashtë vendit.
4. Kurrikulat e programeve përmirësohen vazhdimisht në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, për t'iu përshtatur të kërkesave të kohës dhe në përputhje me kërkesat e tregut dhe kërkesave të brezit të ri.
5. Përdorimi i platforamve/sistemeve të informatizuara për kontrollin e dijes dhe garantimin e transparencës siç është (Pitagora) për publikimin e vlerësimeve dhe platformat e tjera digjitale për një komunikim më të shpejtë midis studentëve dhe stafit akademik apo administrativ.
6. Universiteti "Fan Noli" në Korçë (UNIKO) ka krijuar një rrjet partneriteti dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme, me biznese dhe institucione të tjera shtetërore në mbështetje të objektivave të procesit mësimor, seminareve në terren dhe praktikave profesionale.
7. Qëndrueshmëri ndër vite në numrat e studentëve, megjithëse vihet re një rënie në vitet e fundit.
8. Funksionimi i Këshillit studentor dhe angazhimi i studentëve si përfaqësues në të gjitha organet drejtuese dhe të sigurimit të cilësisë, në nivel Universiteti deri në nivel njësie bazë.

**Pika të dobëta:**

1. Publikimi jo i rregullt i raportimeve financiare, planeve aftagjatë ose afatmesëm financiar etj. **(Standardi IV.5, Kriteri 3)**
2. Përditësimi i Bibliotekës me tituj të rinj nuk është transparent dhe për më tepër, nuk është i qartë në buxhet zëri për shpenzimet për pasurimin e Bibliotekës me tituj të rinj. **(Standardi II.4, Kriteri 5)**
3. Mospërputhje e plotë e silabuseve me VKM 41/2018, sidomos në rubrikën e Literaturës bazë dhe të rekomanduar, e cila nuk është e 5 viteve të fundit dhe në shumë lëndë është shumë e vjetër. **(Standardi IV., Kriteri 1)**

**Rekomandime:**

1. Të zhvillohet një plan afatgjatë për përmirësimin e programeve të studimit, për t'i përshtatur sa më shumë me kërkesat e tregut dhe mundësitë për studentët.
2. Të realizohen auditime të brendshme të rregullta, sidomos për financat, dhe të publikohen raportet financiare dhe planet afatmesme në mënyrë transparente.
3. Të krijohen mundësi për mobilitetin e studentëve dhe të nënshkruhen marrëveshje me institucione të tjera jashtë Shqipërisë për të rritur mundësitë profesionale.
4. Të rritet hapësira dhe të përditësohen titujt e bibliotekës, duke u siguruar që të parashikohet qartë në buxhetet aftamesëm dhe aftagjatë të Institucionit.
5. Të përditësohen silabuset dhe materialet mësimore, duke u siguruar përputhshmëri me standardet më të fundit të fushës dhe literaturë bashkëkohore të 5-viteve të fundit dhe në përputhje me VKM 41/2018.
6. Të investohet për përzgjedhjen dhe implementimin e një programi antiplagjiaturë të formalizuar për të gjithë UNIKO, me qëllim që të sigurohet integriteti akademik dhe të parandalohet përfitimi i padrejtë nga punime shkencore të botuara më parë.
7. Të merren masa dhe të zhvillohen marrëveshje me kompani dhe institucione për mundësi praktike dhe punësimi, në funksion të rritjes së vlerës së diplomës në tregun e punës.

**<u>Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Tourism and Hospitality Management" offered by the Higher Education Institution "Fan S. Noli University, Korça"</u>**

**Strengths and affirmations:**

1. The University of Korça has a strategic position in the eastern region and has historically provided greater support and study opportunities for all students from this region and beyond.
2. The Department of Marketing-Tourism, which offers the Bachelor program in "Tourism and Hospitality Management" has a long 30-year tradition and is stable and consolidated in the programs it offers and the quality of its staff and students.
3. This program was opened in 1992 and was offered for the first time in Albania by UNIKO and has a specialized academic staff that regularly participates in training in the field of tourism and hospitality at home and abroad.
4. The program curricula are constantly improved based on the laws and regulations in force, to adapt to the demands of the time and in accordance with the demands of the market and the demands of the new generation.
5. Use of computerized platforms/systems for knowledge control and guaranteeing transparency such as (Pitagora) for publishing assessments and other digital platforms for faster communication between students and academic or administrative staff.

6. “Fan Noli” University in Korça (UNIKO) has created a partnership network and has signed cooperation agreements with various institutions, businesses and other state institutions in support of the objectives of the teaching process, field seminars and professional practices.
7. Stability over the years in student numbers, although a decline has been noted in recent years.
8. Functioning of the Student Council and engagement of students as representatives in all governing and quality assurance bodies, at the University level up to the basic unit level.

**Weaknesses:**

1. Irregular publication of financial reports, long-term or medium-term financial plans, etc. **(Standard IV.5, Criterion 3)**
2. Updating the Library with new titles is not transparent and, moreover, there is no clear budget line for the expenses for enriching the Library with new titles. **(Standard II.4, Criterion 5)**
3. Complete non-compliance of syllabi with VKM 41/2018, especially in the section on Basic and Recommended Literature, which is not from the last 5 years and in many subjects is very old. **(Standard IV., Criterion 1)**

**Recommendations:**

1. Develop a long-term plan for improving study programs, to adapt them as much as possible to market demands and opportunities for students.
2. Conduct regular internal audits, especially for finances, and publish financial reports and medium-term plans in a transparent manner.
3. Create opportunities for student mobility and sign agreements with other institutions outside Albania to increase professional opportunities.
4. Increase space and update library titles, ensuring that it is clearly foreseen in the Institution's medium- and long-term budgets.
5. Update syllabi and teaching materials, ensuring compliance with the latest standards in the field and contemporary literature of the last 5 years and in accordance with VKM 41/2018.
6. Invest in the selection and implementation of a formalized anti-plagiarism program for all UNIKO, in order to ensure academic integrity and prevent unfair profit from previously published scientific works.
7. Take measures and develop agreements with companies and institutions for internship and employment opportunities, in order to increase the value of the diploma in the labor market.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |